

RAPORTI VJETOR PËR
VITIN **2018**



FOUNDATION ФОНДАЦИЈА
OPEN ОТВОРЕНО
SOCIETY ОПШТЕСТВО
MACEDONIA МАКЕДОНИЈА

#25vite

MBËSHTETJE PËR QYTETARË TË
FUQISHËM DHE AKTIV DHE SHOQËRI
DEMOKRATIKE

PËRMBAJTJA:

25 Vite Fondacioni Shoqëri e Hapur – Maqedoni.....	4
Përmbledhje e aktiviteteve të realizuar në kuadër të dokumentit strategjik për vitin 2018 të Fondacionit Shoqëri e Hapur - Maqedoni.....	5
Raport për aktivitetet e zbatuara në kuadër të koncepteve në vitin 2018.....	7
Arritje kryesore dhe/ose aktivitete që kanë dalluar punën e organizatave që mbështetur në kuadër të fushave strategjike të FShHM-së në vitin 2018.....	35
Listë e granteve në vitin 2018.....	52

25 VITE FONDACIONI SHOQËRI E HAPUR – MAQEDONI

Në vitin 2018, FShHM ka shënuar 25 vjetorin e ekzistimit dhe punës në Maqedoni me një sërë ngjarje rajonale dhe ndërkombëtare në tema me rëndësi shoqërore, organizim të ekspozitave dhe promovim të një filmi dokumentar dhe monografisë. Pothuaj se 25 vite në vijim, FShHM-ja synon krijimin e një shoqërie dinamike dhe tolerante, në të cilën qytetarët janë të fuqishëm, aktiv dhe të përfshirë, ndërsa autoritete janë përgjegjës, llogaridhënës dhe të hapur për bashkëpunim. FShHM-ja ka investuar më tepër se 145 milion dollarë për përmirësim të jetës së qytetarëve, me anë të mbështetjes së vazhdueshme të iniciativave që mundësojnë arsim dhe



shëndetësim më të mirë, sundim i të drejtës, respektim i të drejtave të njeriut, pluralizëm në mediat dhe liri të të folurit. Dedikimi ynë ndaj të rinjve, grupeve të marginalizuar dhe komunitetet lokale është një investim i rëndësishëm për kohezion më të gjerë shoqëror.

Me moton "25 vite mbështetje për qytetarë të fuqishëm dhe aktiv dhe për shoqërinë demokratike", shënimi i 25 vjetorit të FShHM-së filloi

më 3 maj, me promovimin e filmit dokumentar për Fondacionin dhe ekspozitën multimediale, me të cilat janë prezantuar puna dhe arritjet gjatë periudhës së kaluar. Gjatë muajit maj janë organizuar më tepër konferenca në të cilët pjesëmarrësit nga Maqedonia dhe nga jashtë shtetit kanë diskutuar në tema të rëndësishme, siç janë hyrja e Maqedonisë në BE, përforcimi juridik, shëndeti i romëve, liria dhe interneti, të rinjtë dhe shoqëria e hapur, reformat arsimore, fuqia e artit dhe kulturës për ndryshime sociale, si dhe për të ardhmen dhe perspektiva e shoqërisë së hapur në Maqedoni. Pjesa më e madhe e ngjarjeve ishin organizuar në bashkëpunim me organizata tjera qytetare që janë edhe partnerë shumëvjeçar të FShHM-së, si Eurofink, Kodalicioni *Margini*, Fondacioni për Internet dhe Shoqëri *Metamorfozis* dhe Forumi Rinor Arsimor. Një pjesë edhe shënimit të jubileut ishte edhe ekspozita për aktivizëm kreativ, e organizuar në bashkëpunim me Qendrën për Arte Bashkëkohore.



PËRMBLEDHJE E AKTIVITETEVE NË KUADËR TË DOKUMENTIT STRATEGJIK TË FONDACIONIT SHOQËRI E HAPUR - MAQEDONI PËR VITIN 2018

Në kuadër të strategjisë për vitin 2018, FShHM-ja ka shpërndarë resurse për përforsimin e aktorëve qytetar për përfshirje efektive në: **(1)** rinovim të besimit në komunitetet e ndara, me anë të adresimit të polarizimit në vetë komunitetet dhe mes komuniteteve etnike dhe promovim të kohezionit shoqëror dhe vlerës së bashkëjetesës; **(2)** krijimi i një mjedisi reflektiv dhe përmirësim i imazhit publik, besimit dhe relacionet mes aktorëve të shoqërisë civile, dhe **(3)** mbështetje të aktivizmit rinor dhe organizatave për të rinj me qëllim që ata të japin kontributin e tyre për tejkalimin e ndarjeve etnike dhe tjera dhe të punojnë në planin e shkrim/leximit mediatik për të rinjtë në drejtim të njohjes dhe kundërshtimit të manipulimit, të folurit të urretjes dhe propagandës dhe atë, me anë të:

- zbatimit të katër **koncepteve**: (1) Pjesëmarrje qytetare për kohezion shoqëror; (2) Shoqëria qytetare krijon politika publike; (3) Integrimi ndëretnik në arsim; dhe (4) Strategjia e rjetëzimit për përforsim ligjor;
- mbështetje të organizatave qytetare për avancimin e **fushave** vijuese që janë të identifikuar si më të rrezikuara: (1) angazhimi i të rinjve dhe (2) politika shëndetësore të bazuar në të drejta. Këto organizata kanë ekspertizë relevante, qasje në grupe të caktuara të synimit, koalicione të mira dhe bazë të personave, që ju mundëson në mënyrë efektive të artikulojnë strategjitë e tyre dhe të përgjigjen sfidave dhe rrethanave të mundshme.

FShHM-ja dhe partnerët i kanë ndjekur politikat dhe praktikën publike, kanë treguar për gabimet dhe kanë dhënë kontribut në krijimin e politikave publike të bazuar në dëshmi. Ishte vendosur fokus të veçantë: **(1)** krijimi i mjedisit që mundëson shoqërisë qytetare në mënyrë efektive të formulojë politikat publike që kanë të bëjnë me avancimin në kuadër të procesit të aderimit në BE; **(2)** përforsimi i ndikimit të shoqërisë qytetare për përmirësim të politikave publike dhe praktikën për integrim ndëretnik në arsim; **(3)** monitorimi i buxheteve dhe kërkimi i përgjegjësive nga Qeveria për realizim progresiv dhe jodiskriminues të drejtave shëndetësore; dhe **(4)** punë në partneritet me gjithë palët e integruar, për inkorporim të shërbimeve ligjore të batuar në komunitetet të synuar për grupet e marginalizuara në planin kombëtar për zhvillim, me qëllim të sigurohet kornizë e qëndrueshme për përforsimin ligjor (strategjia e rjetit).

Në vitin 2018, FShHM-ja ka siguruar mjete plotësuese nga fondi rezervë për Fondacionet e Shoqërisë së hapur për zbatimin e konceptit *Qytetarët për të Ardhmen*. Duke njohur mundësinë historike pas nënshkrimit të marrëveshjes me Maqedonisë dhe Greqisë për zgjidhjen e kontestit të emrit, si dhe pas marrjes së rekomandimit të kushtëzuar nga BE-ja për fillimin e negociatave në qershor të vitit 2019 dhe ftesa e fituar për aderim në NATO, FShHM-ja në bashkëpunim me dhjetë

organizata qytetare ka zbatuar fushatë të integruar për informim të qytetarëve mbi përfitimet nga integrimi i Maqedonisë në BE dhe NATO. Në këtë mënyrë, iniciativa kishte për qëllim të kontribuojë për dalje më të madhe dhe informim më të gjerë të qytetarëve për referendumin në shtator të vitit 2018.

Shuma e plotë e mjeteve të shpenzuar për zbatimin e aktiviteteve të FShHM-së në vitin 2018 ishte 230.659.401 denarë, prej të cilëve 207.551.363 denarë janë ndarë nga Fondacionet për Shoqëri të Hapur, ndërsa 23.108.039 denarë nga donatorë tjerë.

**RAPORT PËR AKTIVITETET E ZBATUARA NË KUADËR TË
KONCEPTVE NË VITIN 2018**

KONCEPTI: PJESËMARRJA QYTETARE PËR KOHEZION SHOQËROR

Koncepti *Pjesëmarrja Qytetare për Kohezion Shoqëror* ka pasur për qëllim përforsim të aktorëve qytetar për riafrim të kohezionit shoqëror dhe ngritjes së kapaciteteve për përfaqësim dhe avancim të rolit të tyre si promotor të shoqërisë inkluzive. Aktivitetet e konceptit në mënyrë strategjike ishin fokusuar në shtatë qendra të përzgjedhura rajonale, edhe atë: Prilep, Tetovë, Strugë, Strumicë, Shkup, Kumanovë dhe Shtip.

Gjatë vitit 2018, 47 grante kanë vazhduar të zbatojnë aktivitetet e tyre, të dhënë organizatave joqeveritare dhe grupeve joformale në vitin 2017 (dhjetë grante për mbështetje institucionale, dhjetë grante për ndihmë të organizatave joqeveritare nga fondi rezervë, dhjetë ad-hoc grante, gjashtë grante për lajme hulumtuese dhe një grant për monitorim të mediave).

Me qëllimin që aktorët lokal në shtatë qendrat strategjike të përzgjedhura rajonale



të shkaktojnë ndryshime pozitive në qëndrimet dhe në sjelljet e anëtarëve të komuniteteve, si dhe të kontribuojnë për përmirësim të politikave dhe praktikave, demokracinë lokale dhe kohezionin shoqëror, në mars të vitit 2018 ishte publikuar konkurs për dhënie të tre llojeve të granteve për organizatat qytetare, grupe joformale dhe medie lokale. Konkursi ishte synuar për projekte inventive dhe kreative që promovojnë vlerat e shoqërisë së hapur, tregojnë dedikim për kyçe aktive të qytetarëve dhe kanë potencial për arritjen e ndikimit të dukshëm, si dhe qasje integruese me fokus në komunitetet, gjininë dhe personat me aftësi të kufizuara. Në konkursin kanë arritur 61 aplikacione dhe ishin dhënë 25 grante. 15 grantet e dhënë për angazhim të rritur në komunitet (në shumë të plotë prej 77.262 USD) kontribuojnë për zgjedhje të çështjeve aktuale dhe sfidave në komunitetet, që janë si rezultat i nivelit të ultë të kohezionit shoqëror. Gjashtë iniciativat partnere për rritje të

solidarititet gjatë trajtimit të çështjeve me interes të përbashkët (në shumë të plotë prej 51.981 USD) krijojnë mundësi për shkëmbim të njohurive mes aktorëve lokal qytetar dhe për ngritjen e besimit dhe promovimit të kohezionit shoqëror. Mbështetja për krijimin e përmbajtjeve në pesë medie lokale (në shumë të plotë prej 28.000 USD) ka mundësuar pasurim të produksionit të tyre programor me përmbajtje të promovojnë interesin publik, pjesëmarrjen e rritur të qytetarëve në vendimmarrje dhe krijimin e politikave.

Si pjesë e shënimit të 25 vjetorit të ekzistimit të Fondacionit Shoqëri e Hapur – Maqedoni, në maj 2018 në Muzeun e Artit Bashkëkohor në Shkup ishin organizuar dy ngjarje në kuadër të këtij koncepti.

Potencialet dhe mundësitë, por edhe sfidat e shoqërisë së hapur ishin tema kryesore e panel-diskutimeve në kuadër të konferencës dyditore "A ka shanse shoqëria e hapur në Maqedoni?". Në diskutimet e dedikuara shoqërisë së hapur kanë marrë pjesë përfaqësues të shoqërisë qytetare, institucionet shtetërore, mediat, komuniteti akademik dhe ndërkombëtar. Në diskutimet e tyre, pjesëmarrësit në panelet kanë pozicionuar shoqërinë e hapur në udhëkryq, kanë gjetur kërcënimet globale dhe sfidat për vlerat e saj, por edhe kanë theksuar qasje dhe strategji që do të ishin përgjigje efikase sfidave për ruajtjen e standardeve demokratike. Zbulimet nga hulumtimi "Kultura politike, identitetet dhe shoqëria qytetare", përgatitur në bashkëpunim me Institutin për Analiza Sociologjike, kanë inspiruar diskutimet për mënyrat në të cilat shoqëria jonë mund me sukses të përballojë nacionalizimin në rritje, ksenofobinë, apatinë, përjashtimin, mbylljen dhe pasigurinë e aktorëve shoqëror. Dita e parë e konferencës ishte përmbyllur me diskutim mbi sfidat e gjyqësorit të pavarur në Maqedoni dhe avancimi i të drejtave të njeriut dhe lirive, si dhe për rolin e sektorit qytetar në përshpejtimin e reformave gjyqësore. Pjesën e dytë të konferencës e kanë dalluar diskutimet për transparencën dhe llogaridhënien e institucioneve, si imperativ për pushtet të përgjegjshëm dhe shoqëri të përgjegjshme qytetare, që të mund Maqedonia të bëhet dhe të qëndrojë si shoqëri e hapur.

Ngjarja dyditore "Fuqia e pashfrytëzuar e artit dhe kulturës për ndryshime shoqërore" i ka mbledhur në një vend personat që në mënyrë aktive punojnë në fushën e kulturës, por edhe ata që me anë të aktivizmit kulturor arrijnë të nisin ndryshime në shoqëri. Pjesëmarrësit në panel-diskutimet kanë biseduar për mundësitë e aktiviteteve kulturore dhe artistike të ndikojnë mbi rrjedhat shoqërore dhe ndodhitë, të nxisin aksione qytetare dhe të jenë kritikues të pushtetit, kur ajo është e nevojshme. Një pjesë e pjesëmarrësve kanë biseduar edhe për reformat me të cilat artistët dhe aktivistët mund të kundërshtojnë komercializimin dhe humbjen e vlerës së praktikave sociale-kulturore dhe artistike. Në kuadër të ngjarjes janë zhvilluar dy punëtori, njëra me grupin e aktivistëve "Haveit" nga Kosova, ndërsa tjetra me artistin konceptual Stiv Lambert nga SHBA. Ekspozita "Aktivizëm Kreativ" në Galerinë Mobile të Montuar në Shkup, organizuar në bashkëpunim me Qendrën për Arte Bashkëkohore nga Shkupi, ka shfaqur anën kreative të aktivizmit qytetar në

Maqedoni dhe evolucionin përkatëse, specifikat dhe format e shprehjes gjatë dekadës së fundit.

Në Klubin e Qytetarëve për Maqedoni Evropiane (GEM Klubin) që është platformë për shprehje të mendimit kritik dhe hapësirë e hapur për gjitha organizatat qytetare dhe grupe joformale, ishin zhvilluar 167 ngjarje (takime pune dhe punëtori, prezantime dhe konferenca për shtyp, promovime, debate publike, ekspozita të



revistave me fotografi, ligjërata dhe panair i librit) për çështje lidhur me të drejtat e njeriut, grupet e të rinjve të marginalizuar, barazinë gjinore dhe reformat në politikë. Në këto ngjarje, të organizuar nga FShHM dhe 53 organizata, gupe joformale, publikues dhe individë, kanë marrë pjesë 3.351 vizitorë. FShHM-ja ka organizuar promovimin e përkthimeve të tre librave: "Për Politikën" nga Shantall Muf, "Mendja Popullsitë" nga Ernesto Llakalu dhe "Siguri, Territor,

Popullatë" nga Mishell Fuko.

Përfaqësues të organizatave qytetare dhe aktivistë nga Kenia kanë realizuar takime me përfaqësues të institucioneve dhe organizatave qytetare nga Maqedoni për shkëmbim të përvojave dhe ideve për zhvillimin e shoqërisë qytetare.

Në bashkëpunim me Komitetin e Helsinkit për të Drejta të Njeriut në Republikën e Maqedonisë, në tre rajone (Manastir, Shtip dhe Tetovë) FShHM-ja ka filluar të zbatojë monitorim të rregullt të narrativëve ekstrem nacionalist. Zbulimet nga monitorimi dhe analizat do të ofrohen në diskutim publik, me qëllim të tregohet për trendët negative dhe të nxiten debat publike për vlerat e shoqërisë inkluzive, dhe të nxiten komunitetet për gjetje të mënyrave efikase për të përballuar dhe për tejkaluar sfidat me të folurit e urrejtjes.

Në tetor dhe nëntor ishin organizuar tre trajnime për përfaqësuesit e katërmbëdhjetë organizatave, që kanë fituar mbështetje financiare për projektet e angazhimit më të rritur të komunitet dhe rritje të solidaritetit gjatë adresimit të çështjeve me interes të përbashkët. Në trajnimin e parë "Komunikimi me komunitetin lokal dhe përmirësimi i komunikimit mes OJQ-ve dhe komunitetit lokal - Në çfarë mënyre të dëgjohet komuniteti dhe të themelohet dialog kreativ?" kanë marrë pjesë 26 përfaqësues të organizatave qytetare dhe grupeve joformale. Me anë të pjesës teorike, ushtrimeve dhe punës në raste, pjesëmarrësit kanë pasur mundësi të përfitojnë njohuri për bazat, qëllimet, metodologjinë dhe elementet e komunikimit aktiv, si dhe të

njoftohen me më tepër vegla dhe qasje që do të ndihmojnë punën e mëtutjeshme dhe komunikimin e suksesshëm me komunitetet lokale.



Trajnimi i dytë “Angazhimi i suksesshëm dhe mobilizim i komunitetit – pjesëmarrja nuk është asgjë më pak nga dizajnimi i jetës shoqërore” ju ka mundësuar njëzet e dy përfaqësuesve nga trembëdhjetë organizata qytetare dhe grupe joformale të përfitojnë njohuri dhe shkathtësi për planifikimin dhe fushatave, që kanë për qëllim me

sukses të mobilizojnë komunitetin lokal. Në trajnimin “Aktivizëm Kreativ: hip hop, revistë me vizatime, data-vizualizim për fushatë të suksesshme”, pjesëmarrësit kanë fituar shkathtësi për krijim praktik dhe zbatim të fushatave kreative për aktivitete.

FShHM-ja, në bashkëpunim me Qendrën për Aktivizëm Artistik nga SHBA dhe Qendrën për Arte Bashkëkohore nga Shkupi, kanë organizuar Akademinë për Aksion Artistik në Shkup, në të cilën kanë marrë pjesë pesëmbëdhjetë artistë dhe aktivistë qytetar nga Maqedonia.

Pjesëmarrësit në trajnim kanë pasur mundësi të njihen me metodologjinë për aktivizëm kreativ dhe me anë të formave kreative të krijohen zgjidhje personale për problemet e identifikuara lidhur me dominimin e korrupsionit. Trajnimi përfundoi me zbatimin e aksionit kreativ “Agjencia për Shpërndarje të Barabartë të Ryshfetit” që pjesëmarrësit e Akademisë e kanë zhvilluar në qendrën e Shkupit. Tetë



prej këtyre pjesëmarrësve ishin zgjedhur të vijojnë trajnimin për trajnerë që zbatohet nga Qendra për Aktivizëm Artistik nga SHBA, që ka organizuar FShHM-ja në bashkëpunim me Qendrën për Arte Bashkëkohore.

Në bashkëpunim me Programin për Shkëmbim të Arteve pranë Fondacionet Shoqëri e Hapur në Nju Jork, ishte publikuar thirrje për dhënien e granteve për aksione kreative dhe fushata për artistët e angazhuar shoqëror. Për thirrjen kanë arritur 46 aplikacione (katër në afatin e parë dh 42 në afatin e dytë) dhe ishin dhënë njëzet grante, në shumë të plotë prej 50.000 dollarë. Grantet zbatohen në periudhë prej

gjashtë muajve dhe pritet, me anë të përdorimit të shprehjeve artistike, të tregojnë për sfidat aktuale në komunitetet dhe të përfaqësojnë avancim të politikave që ndikojnë mbi zhvillimin e demokracisë lokale dhe arritjes së kohezionit shoqëror.

Përveç kësaj, me grante ishte mbështetur edhe zhvillimi i festivalit “PiçPriç – gala natë e rrëfimit të historive të grave”, pjesëmarrja e regjisores Nela Vitosheviq në programin zhvillimor për mbështetjen të regjisorë teatrore nga Amerika dhe nga bota “Lincoln Lab” në SHBA dhe portalin e internetit Okno.

Në kuadër të këtij koncepti, FShHM-ja në vitin 2018 ka vazhduar me zbatimin e **Projektit të USAID për Pjesëmarrje Qytetare** pesëvjeçar (2016 - 2021) që ka për qëllim të përforcojë kapacitetet e organizatave qytetare dhe të grupeve të rinjve për avancimin e politikave publike, përmirësimin të shërbimeve publike, promovim të sundimit të drejtë dhe kontribut për standard më të mirë të jetës në Maqedoni. Projekti i USAID për pjesëmarrje qytetare zbatohet nga *Ist Vest Menaxhment Instituti*, në partneritet me FShHM-në dhe tre organizata lokale: Fondacioni për Internet dhe Shoqëri *Metamorfozis*, Asociacioni për Iniciativa Demokratike dhe Këshilli Kombëtar Rinor i Maqedonisë.

Projekti përbëhet nga katër komponentë: (1) përforcimi i aleancave/rrjeteve të organizatave të qytetarëve; (2) përforcimi i organizatave qytetare; (3) përforcimi i pjesëmarrjes së të rinjve, dhe (4) përforcimi i aktivizmit rinor.

Roli i FShHM-së është të zbatojë aktivitetet për zhvillim të kapaciteteve të grantistëve, të mbështetur me anë të secilës prej katër komponentëve të Projekteve.

Në kuadër të komponentit të parë dhe të dytë të projektit, gjatë vitit 2018, Projekti i USAID për pjesëmarrje qytetare ka mbështetur tetë organizata qytetare dhe një rrjet të organizatave qytetare që zbatojnë projekte në afat deri më 3 vite. Me anë të zbatimit të metodologjisë për Vlerësimin e Kapaciteteve Organizative dhe Kapacitetet për Përfaqësim (OACA - *Organizational and Advocacy Capacity Assessment*) të organizatave qytetare dhe rrjeteve, zyra e projektit të FShHM-ja ka zbatuar intervista dhe ka përgatitur raporte për kapacitetet e grantistëve. Ekipi i FShHM-së ishte trajnuar nga ana e një eksperti ndërkombëtar për përdorimin e softuerit *Net-Map* analizë për rrjete të organizatave qytetare dhe ka zhvilluar punëtori për *Net-Map* analizë të rrjeteve-grantistë të Projektit. Punëtoritë individuale për planifikim strategjik me secilin grantist, në të cilat janë përfshirë gjithsej 53 pjesëmarrës, kanë rezultuar me përgatitjen e pesë planeve strategjike dhe tetë planeve për ngritje të kapaciteteve dhe plane vjetore të organizatave dhe rrjeteve. Ekipi i FShHM-së siguron mbështetje për zbatimin e tyre, me anë të trajnimeve dhe mentorim individual dhe/ose mbështetje eksperte për përforcimin e kapaciteteve të tyre në fushat e caktuara specifike.

Gjatë vitit 2018, zyra e projektit të FShHM-së ka zbatuar katër trajnime të avancuara për përfaqësim, si dhe për zbatimin e politikave vullnetare dhe praktika për drejtimin e mirë të organizatave qytetare dhe rrjeteve. Janë zbatuar edhe tre trajnime për të

rinj mbi temat: drejtim i projektit dhe rrjetëzim dhe mobilizim i komuniteteve, me grantistët e Projektit të mbështetur me anë të komponentëve për përforsim të pjesëmarrjes së të rinjve dhe përforsim i aktivizimit rinor. Në trajnimet e avancuara dhe ato të rinjve kanë marrë pjesë gjithsej 121 pjesëmarrës. Përveç kësaj, janë zbatuar edhe aktivitete për rrjetëzim, mësim nga bashkëmoshatarët dhe themelimit të dialogut me institucionet (forume për politika publike). Më saktë, ishin organizuar dhjetë takime të *Qarqeve për Mësim* ("Learning Circles") mbi katër tema: "Siguria Kibernetike", "Vullnetarizmi", "Drejtimi Financiar" dhe "Punë me të Dhëna". Në këto takime kanë marrë pjesë 180 përfaqësues të grantistëve të Projektit. FShHM-ja ka organizuar dy forume për politika publike, që kanë përfshirë më tepër se 170 përfaqësues të sektorit qytetar, pushteteve lokale dhe qendrore, përfaqësues të sektorit afarist, akademisë, grupeve joformale, ekspertëve dhe palëve tjera të interesuara. Njëri forum ishte organizuar në bashkëpunim me Qeverinë e Republikës së Maqedonisë dhe ishte fokusuar në luftën kundër dezinformatave, ndërsa i dyti ka mbuluar temën "Perspektivat e Integritimit në NATO: Çfarë do të sjell procesi i aderimit për Maqedoninë dhe qytetarët e saj".

Prej 22 deri më 27 korrik 2018, në bashkëpunim me Fondacionin Barka nga Polonia, ekipi i FShHM-së ka organizuar një vizitë jashtë shtetit për shkëmbim të njohurive të njohurisë dhe përvojave në temën e sipërmarrjes sociale. Tetë përfaqësues të organizatave qytetare që janë pjesë e Projektit, mes të cilëve kishte edhe përfaqësues të FShHM-së, kanë vizituar disa komuna dhe shumë organizata publike dhe private dhe institucione në Poloni që punojnë në këtë temë.

Në qershor të vitit 2018, FShHM-ja ka organizuar për herën e dytë *Javën e Organizatave Qytetare*, me gjithsej njëzet e një ngjarje të zbatuar në dymbëdhjetë organizata qytetare, rrjete ose individuale në njëmbëdhjetë vendbanime, me më tepër se 1.600 pjesëmarrës. Këto ngjarje ishin mbuluar me 220 publikime mediatike. *Karvani i Organizatave Qytetare* i dytë ka përfshirë njëzet përfaqësues të grantistëve të Projektit, që janë takuar me popullatën lokale të fshatrave Karbinci dhe Podaresh, dhe kanë biseduar për problemet komunale, zhvendosjen e të rinjve dhe shkalla e ultë e punësimit të të rinjve, mundësitë për zhvillim të rajonit me anë të avancimit të politikave bujqësore, si dhe për nevojën e përcaktimit pjesëmarrës të prioritetëve dhe sfidave me të cilat përballohet popullata lokale.

Në bashkëpunim me një pjesë të grantistëve të Projektit, FShHM-ja në vitin 2018 ka organizuar tre vizita të shkëmbimit të përvojave në vend. Ishin vizituar tre organizata dhe diskutohej mbi tema specifike në interes të grantistëve, edhe atë: Në Qendrën Rinore Kulturore nga Manastiri diskutohej mbi temën e vullnetarizmit, në Shoqatën për Këshillim, Shërbim, Re integrim dhe Ri-socializim të personave të varur nga substanca psikoaktive *Izbor* nga Strumica ishte diskutuar mbi temën e sipërmarrjes sociale, ndërsa në Koalicionin për Organizata Rinore SEGA nga Prilepi flitej për mundësitë e zgjidhjes së sfidave lokale që ishin identifikuar me anë të *Karvanëve të Organizatave Qytetare* të organizuar në vitin 2017 dhe 2018. Në këto takime në mënyrë aktive kanë marrë pjesë dyzet e një përfaqësues të organizatave dhe

rrjeteve të mbështetur në kuadër të Projektit. Ishin organizuar edhe dy ngjarje për promovim të praktikave të mira, njëri në temën e sipërmarrjes sociale, ndërsa tjetri në temën e sigurisë kompjuterike të organizatave dhe rrjeteve qytetare. Ngjarjet i kanë vizituar më tepër se tetëdhjetë përfaqësues të sektorit qytetar në Maqedoni.



“Përforcimi i qëndrueshmërisë së organizatave qytetare me anë të diversifikimit të burimeve të financimit dhe rritjes së mbështetjes nga aktorët” dhe “Ndërtimi i shkathtësive për komunikim dhe marketing social për mbledhje efektive të mjeteve financiare” janë dy trajnime që kanë zbatuar HORUS nga Shkupi dhe Catalyst nga Serbia, për të cilat FShHM-ja ka siguruar mbështetje logjistike. Këto trajnime janë një

pjesë e aktivitetit më të gjerë që ka për qëllim të kontribuojë për rritjen e qëndrueshmërisë së grantistëve të Projektit.

Ekipi i FShHM-së ka fituar mbështetje nga *Ist Vest Menaxhment Instituti* nga Nju Jorku për nisjen e procesit për fitimin e a.q. NICRA (*Negotiated Indirect Cost Rate Agreement*), me anë përputhjes së politikave organizative dhe praktikave në përputhje me kërkesat dhe standardet e USAID-it.

Gjatë gjithë periudhës, ekspertë ndërkombëtarë kanë mentoruar dhe kanë mbështetur ekipin e FShHM-së.

KONCEPTI: SHOQËRIA QYTETARE KRIJON POLITIKA PUBLIKE

Koncepti *Shoqëria Qytetare Krijon Politika Publike* ka pasur për qëllim të krijojë një mjedis mundësues për pjesëmarrje efektive të shoqërisë qytetare në krijimin e politikave publike lidhur me avancimin e vendit në procesin e aderimit në BE.

Qëllimet specifike të konceptit janë: **(1)** të mbështeten aleancat qytetare për monitorimin e pavarur të politikave publike në fushat e gjyqësorit, anti-diskriminimit dhe antikorrupsionit dhe për dhënien e kontributit në krijimin e politikave publike, dhe **(2)** të mbështeten organizatat qytetare për zbatimin e monitorimit të reformës së administratës publike dhe përfaqësimit për transparencë më të madhe, llogaridhënie dhe përfshirje.

Në përputhje me planin vjetor mbrojtës të aktiviteteve dhe buxhetit, në vitin 2018 ishin realizuar grupe të aktiviteteve për arritjen e qëllimeve specifike, që janë lidhur mes vete dhe plotësohen, edhe atë me anë të:

(1) Skemë granti për tre rrjete qytetare/aleanca për monitorimin e pavarur të politikave publike në fushat e gjyqësorit, antidiskriminimit dhe antikorrupsionit, që ka përfshirë:

- mbështetje të Komitetit të Helsinkit për të Drejta të Njeriut të Republikës së Maqedonisë, Institutit për të Drejtat e Njeriut, Institutit për Politika Evropiane, Shoqëria Maqedonase për Juristë të rinj, Koalicioni Të gjithë për Gjykim të Drejtë dhe Qendra për Hulumtime dhe Analiza Juridike, që ndjekin procesin e zbatimit të Strategjisë për Reforma në Gjyqësorin (2017 – 2022) dhe Planin e Veprimit. Me anë të mbështetjes është përgatitur dhe prezantuar njoftim (brief) monitorimi¹ nga monitorimi i reformave në gjyqësorin;
- Mbështetje të Platformës për Luftë kundër Korrupsionit, që ka përgatitur dhe prezantuar tre dokumente për politika të brendshme: "Në çfarë mënyre të arrihet integritet në Komisionin Shtetëror për Ndalimin e Korrupsionit?", "Bashkëpunimi i sektorit qytetar me palët e interesuar në iniciativat për parandalim dhe luftë kundër korrupsionit" dhe "Niveli i transparencës së institucioneve kompetente nëpërmjet prizëm së organizatave qytetare në nivelin qendror". Platforma e Organizatave Qytetare për Luftë kundër Korrupsionit ka nisur iniciativë tek Kuvendi i Republikës së Maqedonisë për zgjedhje të dy anëtarëve të Komisionit Shtetëror për Ndalimin e Korrupsionit²;
- Mbështetje të Koalicionit *Margini* që përfaqësohet për miratimin e Ligjit për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe monitorin zbatimin përkatës.



(2) Mbështetje të qasjes inventive "Vërtetëmatës" për vlerësimin e punës së Qeverisë në krahasim me prioritetet e deklaruara nga Programi Vjetor i Qeverisë si dhe për vlerësimin e premtimeve zgjedhore të partive politike në tre fushat, që ka përfshirë:

¹ Mund të gjendet në:

<http://fosm.mk/mk/Home/NewsAndActivity?newsID=11634&catID=7&pageIndex=1&month=0&year=0&additionalID=125>

² Mund të gjendet në:

<http://fosm.mk/mk/Home/NewsAndActivity?newsID=11592&catID=7&pageIndex=1&month=0&year=0&additionalID=125>

- grant të Fondacionit për Internet dhe Shoqëri Metamorfozis për mbështetje të veglës për monitorim “Vërtetëmatës” (<http://vistinomer.mk/>), me të cilën vlerësohet plotësimi i deklaratave dhe premtimeve të Qeverisë dhe aktorëve tjerë politik, lidhur me Prioritetet Urgjente Reformuese në fushat e gjyqësisë, administratës publike dhe luftës kundër korrupsionit, me sigurimin e vizualizimit grafik që është e lehtë për të lexuar për qytetarët dhe i sistematizon të dhënat;
- pjesëmarrje në konferencën me temë e-society.mk, në të cilën ishin promovuar raporti final “Observatori i Reformave në Medie” dhe dokumenti për politika publike “Reforma në Gjyqësorin, Administratën Publike dhe Luftën kundër Korrupsionit”.



(3) Përfaqësimi për transparencë më të madhe dhe llogaridhënie të institucioneve me anë të përmirësimit të kornizës ligjore për qasje në informacionet me karakter publik dhe luftë kundër korrupsionit dhe konfliktit të interesave, që ka përfshirë:

- pjesëmarrje të një përfaqësuesi të FShHM-së në grupin e punës për përgatitje të Ligjit për Qasje të Lirë në Informacione me Karakter Publik të ri, në drejtim të përcaktimit të interesit publik dhe përdorimit të detyrueshëm të “testit të dëmit”, rritje të shtrirjes së bartësve të informacioneve (partitë politike), rritje të kompetencave të organit të shkallës së dytë me kompetenca ndëshkimore, përmirësim i efikasitetit dhe efektivitetit të organit të shkallës së dytë me anë të ndryshimit të strukturës në organ inoks;
- përgatitje të dokumentit për politika publike “Propozime për Ndryshim të Ligjit për Qasje të Lirë në Informacione me Karakter Publik dhe përmirësim të përdorimit të Ligjit”³;
- pjesëmarrje të një përfaqësuesi të FShHM-së në grupin e punës për përgatitje të Strategjisë për të Dhëna të Hapura, si dhe në grupin e punës me palët e



³ Mund të gjendet në: <http://www.fosm.mk/CMS/Files/Documents/Policy%20Brief%2012-01-2018.pdf>

interesuara për monitorimin e avancimit të Strategjisë për të Dhëna të Hapura dhe Planin e Veprimit 2018-2020;

- pjesëmarrje të përfaqësuesve të FShHM-së në përgatitjen e Planit Kombëtar të Veprimit pranë Partneritetit të Hapur Qeveritar 2018-2020, si dhe në grupin e punës me gjithë aktorët e përfshirë në zbatimin e Planit Kombëtar të Veprimit pranë Partneritetit të Hapur Qeveritar 2018-2020;
- pjesëmarrje të përfaqësuesit të FShHM-së në grupin e punës për përgatitje të Ligjit për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesave të ri, në drejtim të përmirësimit të modelit për zgjedhje të Komisionit Shtetëror për Luftë kundër Korrupsionit dhe rritjes së kompetencave të komisionit;
- organizimi i katër takimeve të punës me përfaqësues të Drejtorisë për Siguri dhe Mbrotjtje të Informacioneve të Klasifikuara dhe me përfaqësues të Misionit të OSBE-së në RM, në drejtim të nevojës për zbatimin praktik të "testit të dëmit", që do të kontribuojë për tejkalimin e keqpërdorimeve për refuzim të qasjes në informacione dhe klasifikim të informacioneve.

(4) grant për Eurofink – Qendra për Strategji Evropiane për monitorimin e procesit të aderimit në BE dhe monitorim të përdorimit të fondeve evropiane, që ka përfshirë:

- përgatitja dhe promovimi i "Analizës Krahasuese të Raporteve të Komisioneve Evropiane për Përparimin e RM-së 2014-2018"⁴, me të cilën në mënyrë ilustruese është treguar përparimi i proceseve të integritetit evropian sipas kapitujve;
- përgatitja dhe prezantimi i pesë dokumenteve për politika publike lidhur me procesin e aderimit të Maqedonisë në Bashkimin Evropian, të emëruar si "Ditari i Aderimit"⁵, me të cilën monitorohet puna e Qeverisë, zhvillimi i politikave evropiane, zbatimi i Prioriteteve Urgjente Reformuese dhe dialogun e rregullt politik mes Maqedonisë dhe Bashkimit Evropian;

⁴ Mund të gjendet në:

<http://fosm.mk/mk/Home/NewsAndActivity?newsID=11506&catID=7&pageIndex=2&month=0&year=0&additionalID=125>

⁵ Shkresa 1 – "Çfarë do të sjell viti 2018", mund të gjendet në:

<http://fosm.mk/mk/Home/NewsAndActivity?newsID=11497&catID=7&pageIndex=3&month=0&year=0&additionalID=125>, Shkresa 2 – "Strategji e besueshme për zgjerimin me Ballkanin Perëndimor", mund të gjendet në:

<http://fosm.mk/mk/Home/NewsAndActivity?newsID=11508&catID=7&pageIndex=2&month=0&year=0&additionalID=125>, Shkresa 3 – "Gjysmë hap përpara", mund të gjendet në:

<http://fosm.mk/mk/Home/NewsAndActivity?newsID=11538&catID=7&pageIndex=2&month=0&year=0&additionalID=125>, Shkresa 4 – "Në milimetër para negociatave", mund të gjendet në:

<http://fosm.mk/mk/Home/NewsAndActivity?newsID=11595&catID=7&pageIndex=2&month=0&year=0&additionalID=125>, Shkresa 5 – "Potencialet dhe kurthet e IPA 3, mund të gjendet në:

<http://www.fosm.mk/mk/Home/Publication?newsID=12678&catID=9&pageIndex=1>

- organizimi i "Shkollës për Politika Evropiane" në kuadër të së cilës, me anë të punëtorive dhe diskutimeve me ekspertë kombëtar dhe rajonal nga Serbia dhe Mali i Zi, përfaqësues qeveritar dhe përfaqësues të organizatave qytetare kanë shqyrtuar modele dhe mundësi për pjesëmarrje të organizatave qytetare në procesin e negociatave të Maqedonisë me Bashkimin Evropian;



- organizimi i konferencës rajonale "Përse Evropa, përse tani?!", në të cilën ishin përcaktuar qëllimet e shoqërisë qytetare nga Maqedonia dhe nga rajoni në pritje të zhvillimit të Samitit të Be-së për Ballkanin Perëndimor në Sofje. Nga kjo konferencë doli edhe një dokument për politika publike "Përse Evropa, përse tani?!"
- "6, që ishte prezantuar në Samitin në Sofje dhe në takim të organizatave qytetare në Bruksel.

(5) Monitorimi i reformës së administratës publike që zbaton FShHM-ja me anë të projektit *Aleanca Qytetare për Transparencë – Monitorimi i procesit të reformave në administratën publike nga ana e organizatave qytetare*, që mbështetet nga Bashkimi Evropian me IPA Instrumentin Financiar për Shoqëri Qytetare dhe programit për medie për vitin 2015, që ka përfshirë:



- grant skemë për mbështetje të gjashtë organizata qytetare për zbatimin e monitorimit të institucioneve publike dhe cilësisë së shërbimeve publike në nivelin lokal, në shumë prej 50.000 euro;
- përgatitje dhe prezantim të "Raportit të Parë për Shkallën e Zbatimit të Strategjisë për Reforma në Administratën Publike 2018-2022"⁷, për periudhën shkurt-qershor

2018;


⁶ Mund të gjendet në:

<http://fosm.mk/mk/Home/Publication?newsID=11573&catID=9&pageIndex=1>

⁷ Prezantimi publik i Raportit të Parë për Nivelin e zbatimit të Strategjisë për Reforma në Administratën Publike 2018-2022, Mund të gjendet në

<http://fosm.mk/mk/Home/NewsAndActivity?newsID=11617&catID=7&pageIndex=1&month=0&year=0&additionalID=118>

- përgatitje të dokumentit për politika publike “Sektori publik i krijuar sipas masës: diskutim për madhësinë e administratës publike në Maqedoni”⁸;
- përgatitje të dokumentit për politika publike “Kontributi për raportin gjysmë-vjeçar për Strategjinë për Reforma në Administratën Publike”⁹.
- organizimi i konferencës vjetore në temën “Krijimi i politikave publike nga perspektiva e integritit evropian” në të cilën kanë marrë pjesë më tepër se shtatëdhjetë funksionarë qeveritar, të punësuar në administratën dhe përfaqësues të shoqërisë qytetare;
- publikimi gjashtë analizave¹⁰ të bazuar në zbulimet nga monitorimi i reformës së administratës publike, që fokusohen në: zbatimin e Ligjit për Gjyhet nga viti 2008; pjesëmarrje të palëve të interesuar në procesin e miratimit dhe ndryshimit të Ligjit për Ndërtim; pjesëmarrje të palëve të interesuara në procesin e miratimit të Strategjisë për Reforma në Administratën Publike 2018-2022; puna e Agjencisë për të Rinj dhe Sport; funksionimi i mekanizmave për konsultim me palët e interesuara në Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujit, dhe efikasiteti i mbrojtjes që siguron Komisioni për Mbrojtjen e të Drejtës për Qasje të Lirë në Informacione me Karakter Publik.



Përveç kësaj, në kuadër të konceptit zbatohet edhe projekti **Mbështetje të Maqedonisë për Integrim në BE dhe NATO**, me mjete nga fondi rezervë¹¹ i Iniciativës për Shoqëri të hapur në bashkëpunim me Institutin për Politika Evropiane pranë Shoqërisë së Hapur. Mbështetja që zbatohet ka të bëjë me: **(1)** përgatitjen e studimit të vizibilitetit dhe planit për përfaqësim për monitorim ndërkombëtar të gjykrimeve për korrupsion në nivel të lartë dhe krimin të organizuar; **(2)** angazhimi i profesionistëve që do të ndihmojnë Qeverinë në procesin e aderimit/negociatave; dhe **(3)** dokumente për politika publike: “Marrëveshja për

⁸ Dokument për politika publike, Mund të gjendet në:

<http://fosm.mk/mk/Home/NewsAndActivity?newsID=11556&catID=7&pageIndex=2&month=0&year=0&additionalID=118>

⁹ “Kontribut për raportin gjysmë vjetor të Strategjisë për Reforma në Administratën Publike”, mund të gjendet

në:http://fosm.mk/mk/Home/NewsAndActivity?newsID=11579&catID=7&fbclid=IwAR1sgr3CN2Xa3d64-ZvHLR8VdrVoDmgcG-7xZdyvFdOzxl_p0gmHSt6x7-o

¹⁰<http://fosm.mk/mk/Home/NewsAndActivity?newsID=11577&catID=7&pageIndex=1&month=0&year=0&additionalID=118>

¹¹ Shpërndarja për Fondacionin Shoqëri e Hapur – Maqedoni me anë të konceptit Shoqëria Qytetare Krijon Politika Publike nga Fondi Rezerva/Rezerva e Përgjithshme/fondi Rezerva Evropian.

emrin maqedonas dhe pas kësaj: perspektiva gjeopolitike", "Referendumi në fokus: fundi i rrugës për aderim të Maqedonisë në BE dhe NATO ose vetëm fundi i rrugës?" dhe "Rruga e Maqedonisë për BE dhe NATO dhe implikimet rajonale" ¹².

Si pjesë e aktiviteteve operative, përfaqësues të FShHM-së kanë marrë pjesë në: (1) grupin themelues, i përbërë nga gjashtë organizata, për përgatitje të dokumentit "Udhërrëfyesi për zhvillimin e organizatave qytetare 2018-2022"; (2) grupi i punës për përgatitjen e ndryshimeve dhe plotësimeve të Vendimit për Themelimin e Këshillit të Qeverisë për Bashkëpunim dhe Zhvillim të Sektorit Qytetar dhe aktivitete përfaqësuese para Qeverisë; (3) përgatitjen e komenteve për Strategjinë për Bashkëpunim dhe Zhvillim të Shoqërisë Qytetare 2018-2020, dhe (4) grupi i punës për zhvillimin modelit të përfshirjes së organizatave qytetare në strukturën e negociatave të shtetit me BE.

KONCEPTI: INTEGRIMI NDËRETNIK NË ARSIM

Në kuadër të konceptit *Integrimi Multi-etnik në Arsim*, dhe me qëllim të përforcimit të ndikimit të shoqërisë qytetare për përmirësim të politikave arsimore dhe praktikave të fokusuar në integrimin ndëretnik në arsim, FShHM-ja aktivitetet në vitin 2018 ka drejtuar në: **(1)** mbështetje të iniciativave që do të shërbejnë si shembuj të praktikës së mirë për mësim të përbashkët dhe punë, si dhe **(2)** mbështetje të pjesëmarrjes së shoqërisë qytetare në dialogun për reforma arsimore.

Nga kjo, në kuadër të **mbështetjes për iniciativa që do të nxisin integrimin ndëretnik në arsim, dhe do të shërbejnë si shembuj të praktikës së mirë për mësim dhe punë të përbashkët** ishin zbatuar aktivitetet vijuese:

- Mbështetje të projekteve në dhjetë shkolla fillore në të cilat mësimi zhvillohet edhe në disa gjuhë të komuniteteve më të vogla etnike, si dhe në shkollat e mjediseve rurale. Qëllimi ishte të mbështetet integrimi multi-etnik në arsim me anë të promovimit të dallimeve etnike, kulturore dhe gjuhësore si përparësi, me anë të nxitjes së pjesëmarrjes aktive dhe bashkëpunimit të ndërsjellë të nxënësve, mësimitdhënësve, prindërve dhe komunitetit lokal në jetë shkollare, promovim të praktikave të mira në mësim, të mësuarit dhe organizimin e nxënësve, etj.



¹² Mund të gjendet në: <http://www.fosm.mk/mk/Home/Publications?catID=9>

- Një thirrje publike për të dëgjuar mendimet e nxënësve të shkollave të mesme nga shkollat e mesme shtetërore në Republikën e Maqedonisë për cilësinë e arsimit, si dhe idetë e tyre për përmirësime. Në thirrjen janë paraqitur tridhjetë e nëntë nxënës të shkollave të mesme dhe ishin shpërblyer njëmbëdhjetë prej tyre. Me anë të eseve, letrave dhe revistave me vizatime, nxënësit e shkollave të mesme kanë ndarë mendimet e tyre për të se si duhet të duket një shkollë ideale dhe mësimdhënës ideal. Një pjesë e nxënësve të shkollave të mesme, nga ana tjetër, në punimet e tyre u drejtuan Ministrin të Arsimit dhe Shkencës.



- Konkurs për mësimdhënës të suksesshëm dhe për praktika të mira mësimore në të cilat janë paraqitur gjithsej njëqind e trembëdhjetë mësimdhënës nga shkollat fillore (ato klasore dhe të lëndëve) dhe nga shkollat e mesme. Nëntë prej tyre, ose nga tre për secilën nën-kategori, që sipas mendimit të FShHM-së kanë pasur orët më

të mirë/kreative, kanë fituar shpërblim në të holla, ndërsa shkolla e tyre ka fituar një donacion prej materialeve didaktike. Qëllimi i thirrjes ishte të promovohet profesioni i mësimdhënësit, si dhe individët e dedikuar që japin kontributin e tyre në avancimin e procesit edukativo-arsimor, me fokus të veçantë në nxitjen e të menduarit kritik, kreativitetin, zbatimin e të mësuarës, dhe zhvillimit të kompetencave sociale të nxënësve.

- Marrëveshje për bashkëpunim me Fakultetin Filologjik "Bilazhe Koneski" pranë Universitetit "Shën Kirili dhe Metodi" – Shkup për realizimin e projektit "Mësimi i gjuhës së tjetrit: Studentë aktiv për kohezionin shoqëror". Projekti ka për qëllim të nxit dhe të avancojë kompetencat gjuhësore të studentëve që stimulon shumë gjuhësinë, gjegjësisht mësimin paralel të gjuhës shqipe, turke dhe maqedonishte, me anë të kurseve intensive, speciale të dizajnuar për semestër që duhet të sigurojnë hyrje të sigurt në fushën e kompetencave kulturore të studentëve.

Mbështetja për pjesëmarrjen dhe kontributin e shoqërisë qytetare në dialogun për reforma arsimore ishte realizuar me anë të:

- Projekte që zbatojnë katër organizata qytetare, në partneritet me shkollat e mjedisit të tyre lokal, me qëllim të promovimit të konceptit të arsimit inkluzive dhe shkollave inkluzive si mjedis stimulues në të cilën kuptohen dhe vlerësohen dallimet, vend që secili nxënës ndjehet i mirëseardhur dhe mund në mënyrë maksimale të përdor potencialet për pjesëmarrje, mësim dhe avancim. Projektet kanë promovuar praktika të bashkëpunimit cilësore mes shkollave dhe

organizatave joqeveritare në pjesën e aktiviteteve të lira të nxënësve dhe arsimit joformal.

- Punëtorin në temën "Tendenca bashkëkohore në arsimin e lartë për edukuesit dhe lidhja me praktikën" në bashkëpunim me Fakultetin Pedagogjik "Shën Klimenti i Ohrit" nga Shkupi. Qëllimi i punëtorie ishte të analizohen dhe përcaktohen mundësitë për avancim të lidhjes mes arsimit fillestar të edukatorëve dhe praktikës, në aspekt të qasjeve integruese ndaj mësimit dhe transferimit të njohurisë, vendosjes së planeve mësimore, trajnimeve profesionale dhe zhvillimit të kuadrove. Pjesëmarrja e përfaqësuesve të institucioneve të arsimit të lartë për përgatitjen e edukatorëve, institucioneve parashkollore, si dhe përfaqësues të Ministrisë së Punë dhe Politikës Sociale, Byrosë për Zhvillimin e Arsimit dhe organizatat ndërkombëtare ka mundësuar një diskutim për aspektet kryesore të rregullores ligjore që duhet të miratohet gjatë periudhës vijuese, dhe të rregulloj fushat e punës së institucioneve parashkollore dhe të punësuarve. Konkluzionet nga puna në grupe, si dhe propozimet për përmirësime, ishin dorëzuar tek gjithë pjesëmarrësit e punëtorisë dhe institucionet relevante që janë përgjegjës për rregullimin e arsimit parashkollor dhe edukimin, si dhe tek institucionet e arsimit të lartë për arsimin fillestar të edukatorëve.



- Hulumtimi i filluar për autonomi universitare, në bashkëpunim me Sindikatën e Pavarur Akademike, me qëllim të përcaktimit të perceptimit/kuptimit për autonominë universitare, si dhe nivelin e realizimit të autonomisë universitare në arsimin e lartë në Republikën e Maqedonisë me anë të prizës së indikatorëve të Asociacionit Universitar Evropian. Raporti hulumtues përfshin analizë të politikës arsimore në arsimin e lartë dhe të ligjeve, anketë/pyetësor për të analizuar qëndrimet dhe mendimet e përfaqësuesve të universiteteve në lidhje me realizimin e vërtetë të gjitha fushave të autonomisë universitare në arsimin e lartë në Republikën e Maqedonisë dhe krahasimi me nivelin e realizimit të autonomisë universitare në hapësirën evropiane të arsimit të lartë. Zbulimet dhe rekomandimet nga ky hulumtim do të ndahen me gjithë palët e interesuara, përfshirë edhe me Këshillin Kombëtar për Arsim të Lartë dhe Veprimtarisë Shkencore-Hulumtuese, në fillim të vitit 2019.
- Vizita të shumë shkollave në të cilat mësimi zhvillohet në gjuhët e komuniteteve të vogla etnike (turke, boshnjake dhe serbe) nga ana e FShHM-së për të zbuluar gjendjet dhe të mblidhen të dhëna për nevojat e tyre për avancimin e mësimit. Zbulimet nga vizitat do të përfshihen në studimin themelor që do të shërbejë për

vendosje të dimensioneve të intervenimeve në konceptin *Arsimit i Komuniteteve më të Vogla Etnike*, të planifikuar për periudhën strategjike 2019-2022.

- Konferenca në të cilat ishin diskutuar zbulimet dhe rekomandimet nga dy hulumtimet. "Arsimi i mësimdhënësve në arsimin fillor në RM" është hulumtim i nisur nga FShHM-ja para fundit të vitit 2017, që është zbatuar në bashkëpunim me një ekip të profesorëve të institucioneve shtetërore të arsimit të lartë për mësimdhënës nën RM. Hulumtimi jep një analizë të vendosjes ligjore, institucionale, organizative dhe programore të arsimit të mësimdhënësve, identifikon problemet (ngjashmëritë dhe dallimet mes vetë fakulteteve) në aspekt të regjistrimit, mënyrën në të cilën realizohet arsimi fillestar (akreditimi, programet studimore, kompetencat dalëse dhe profilet/diplomat, përputhja me Kornizën Evropiane të Kualifikimeve, etj.), hyrja në profesionin dhe format e perfeksionimit profesional. Në kohën e njëjtë hulumtimi jep rekomandime për përmirësimin e gjendjes. Zbulimet dhe rekomandimet nga hulumtimi ishin temë e konferencës që ishte zhvilluar në kuadër të shënimit të 25 vjetorit të FShHM-së, në të cilën kishte fjalim edhe ministria e atëhershme e arsimit dhe shkencës, dhe me mendime personale për gjendjet aktuale lidhur me profesionin e mësimdhënësit kanë prezantuar edhe profesorë dhe ekspertë nga Sllovenia, Bosnja dhe Hercegovina dhe nga Kosova, si dhe drejtori i Programit të Rrjetit për Arsim pranë Fondacioneve të Shoqërisë së Hapur. Hulumtimi "Sa dhe për çfarë shpenzon një student maqedonas?" ishte nisur nga FShHM-ja në fund të vitit të kaluar, dhe ka zbatuar një ekip i përbashkët i hulumtuesve të rinj nga Shoqata të Analistëve të Rinj dhe Hulumtues (ZMAI) dhe nga Forumi Rinor Arsimor. Hulumtimi ka mapuar llojin dhe shumën e shpenzimeve të studentëve që studiojnë në pesë universitetet shtetërore të RM-së, burimet e financimit, shprehitë jetësore dhe kulturore të studentëve dhe faktorët që ndikojnë mbi standardin e cilësisë së jetës dhe ka dhënë rekomandime për aktorë të ndryshme në drejtim të përmirësimit.



Mjetet plotësuese të siguruar nga programet tematike për arsim pranë Fondacionet Shoqëri e Hapur kanë avancuar portofolin programor dhe tematik të FShHM-së dhe partnerëve strategjik përkatës. Me anë të mbështetjes për iniciativën e Forumit Rinor Arsimor "Shtëpi Studentore pa Korrupsion", programi për arsim të lartë pranë Fondacioneve Shoqëri të Hapur ka mbështetur anikorrupsionin, si një prej temave tona kryesore strategjike, këtë herë në fushën e arsimit të lartë. Programet për mbështetje të arsimit dhe zhvillimit të hershëm pranë Fondacioneve Shoqëri të Hapur nga Londra kanë ndihmuar për qëndrueshmërinë dhe për institucionalizimin e

një segmenti të rëndësishëm të aktiviteteve programore (komunitetet për mësim) të Fondacionit për Iniciativa Arsimore dhe Kulturore "Hap pas hapi" që janë njohur nga shkollat dhe nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës, si model efikas alternativ për zhvillim profesional të mësimdhënësve dhe resurse të rëndësishme shkollor për mësim bashkëpunues dhe shkëmbim të praktikave të mira.

FShHM-ja ka nënshkruar marrëveshje me Ministrinë e Punës dhe Politikës Sociale për rinovim/adaptim të çerdheve për fëmijë në komunat Kriva Pallankë dhe Rosoman. Komunitetet janë përgjegjës për zbatimin e procedurave për adaptim të hapësirave në ndërtesat aktuale, me qëllim të rritjes së shtrirjes së fëmijëve në këtë dy vende, pajisja dhe materialet didaktike për hapësirat e reja do të prokurohen nga Ministria e Punës dhe Politikës Sociale.

Me mjetet e siguruar nga Fondi Arsimor i Romëve nga Budapesti, FShHM-ja edhe në vitin 2018 ka administruar bursat në kuadër të programeve **RSMUP dhe RHSP**, me çfarë është vazhduar me mbështetjen e trendit të rritur të romëve të rinj që mbarojnë studimet deridilomike dhe postdiplomike në mjekësi dhe fusha tjera studimore.

STRATEGJIA RRJET PËR PËRFORCIMIN LIGJOR

Qëllimi i përgjithshëm i punës së FShHM-së në kuadër të *Strategjisë Rrjet për Përforcimin Ligjor* është zhvillimi dhe zbatimi i politikave zhvillimore për përforcim ligjor, që, në nivelin kombëtar dhe lokal, do të mundësojnë qasje në drejtësi për të varfrit dhe grupet e marginalizuara të qytetarëve (romët, punëtorët seksual, personat që përdorin drogë, punëtorët në tekstil). Me anë të punës së përbashkët me përfaqësues të institucioneve relevante kombëtare dhe lokale, komuniteti akademik, organizatat qytetare dhe përfaqësues e grupeve të interesuar të qytetarëve, FShHM-ja synon avancimin e mundësive për institucionalizim dhe qëndrueshmëri të formave të ndryshme të qasjes në drejtësi të bazuar në komunitet.

Në përputhje me planin vjetor mbrojtës të aktiviteteve dhe buxhetit, në vitin 2018 ishin realizuar grupe të aktiviteteve për arritjen e tre qëllimeve specifike, që janë lidhur mes vete dhe plotësohen, edhe atë me anë të: **(1)** institucionalizimi i përforcimit ligjor me anë të zhvillimit të politikave kombëtare dhe lokale për përforcim ligjor, në bashkëpunim me gjithë palët e interesuara – përfaqësues të institucioneve relevante kombëtare dhe lokale, komuniteti akademik, organizatat qytetare dhe përfaqësues të grupeve të interesuar të qytetarëve; **(2)** sigurimi i qëndrueshmërisë së formave të ndryshme të qasjes në drejtësi, dhe **(3)** sigurimi i furnizimit të vazhdueshëm të shërbimeve cilësore ligjor dhe përforcimit ligjor për grupet e varfër dhe të marginalizuara të qytetarëve (romët, punëtorët seksual, personat që përdorin drogë, punëtorët në tekstil).

Në drejtim të realizimit të qëllimit të parë specifik, gjegjësisht **institucionalizimit të përforcimit ligjor**, për të veçuar janë aktivitetet vijuese:

- Në proces konsultues me përfaqësues të Ministrisë së Drejtësisë (MD) dhe Ministrisë së Punës dhe Politikës Sociale (MPPS), në nivelin kombëtar janë pranuar sy përpjekje në temën prioritare *Qasje në Drejtësi*, gjatë së cilës përforcimi ligjor është përfshirë në Planin e Katër të Veprimit të Partneritetit të Hapur Qeveritar 2018-2020 (NAP). Dy përpjekje janë të lidhur me qëllimin e zhvillimit të qëndrueshëm 16.3, që do të kontribuojë për realizimin e qëllimit të parë specifik, por edhe për promovimin e sundimit të së drejtës në nivelin kombëtar dhe ndërkombëtar dhe sigurim të qasjes në drejtësi. Me vendim të Ministrisë së Shoqërisë Informatike dhe Administratë, përfaqësuese të FShHM-së janë pjesë e grupit të punës për zbatimin e kësaj teme prioritare nga NAP-i i katërt. Në drejtim të shkrirjes së qëllimit për zhvillim të qëndrueshëm 16.3 në ligjin kombëtar, ishte përcaktuar një listë me indikatorë që shërben si bazë për mbledhjen e gjitha të dhënave relevante që janë në dispozicion. Në nivel të institucionalizimit sektorial të përforcimit ligjor, MPPS-ja ka përfshirë para-juristët si pjesë e Qendrës Informative për Romët (QIR). Në zhvillim është procedurë për sistematizim të ri të Qendrave për Punë Sociale (QPS), në të cilët të punësuarit nga Qendrat Informative për Romët do të jenë të punësuar me orar të rregullt në Qendrat për Punë Sociale. Gjatë periudhës vijuese, për të punësuarit në QIR do të sigurohet trajnim për para-juristë, me qëllim të përfitimit me njohuri për fushat në të cilat qytetarët më shpesh kanë probleme ligjore. Në kohën e njëjtë, në nivelin lokal, në dy komuna (Shuto Orizare dhe Prilep) me anë të bashkëpunimit me organizata qytetare dhe autoritetet lokale do themelohen Qendra për Qasje në Drejtësi për Romët dhe Grupet tjera të Cenuar. Në komunën Shuto Orizare, përforcimi ligjor u bë pjesë e politikave lokale me përfshirjen e Qendrës për Qasje në Drejtësi në planin komunal të veprimit dhe përcaktimin e buxhetit të synuar për funksionimin e qendrës në vitin 2018. Përveç kësaj, në përputhje me Strategjinë Kombëtare për Integrim të Romëve, në dymbëdhjetë komuna në zbatim është hartimi i planeve operative për përforcimin ligjor, dhe pritet që ato të bëhen pjesë e Planeve Lokale të Veprimit për integrim të romëve gjatë vitit 2019. Për të zbatuar në mënyrë përkatëse politikat lokale dhe më mirë të njoftohen me konceptin e përforcimit ligjor, në vitin 2019 do të zbatohen seminare për përforcimin ligjor të synuar për përfaqësues të institucioneve ligjore.
- Për të siguruar qëndrueshmëri të ndihmës juridike falas dhe shoqatave që sigurojnë këtë ndihmë për tetë vitet e kaluara, FShHM-ja ka monitoruar zbatimin e Ligjit për Ndihmë Juridike Falas (LNJF), gjatë së cilës mangësitë e përcaktuara të ligjit aktual, por edhe të sistemit të ndihmës juridike falas në tërësi, ishin bazë për hartimin e katër dokumenteve për politika publike që ishin dërguar tek institucionet përkatëse. Në bashkëpunim me gjashtë shoqata që autorizuar për dhënien e ndihmës juridike falas janë përgatitur dy dokumente me komente për Propozim-Ligjin që ishte përgatitur nga ana e ekspertit të nga Latvia dhe ishin theksuar mangësitë e tekstit të ri të Propozim-Ligjit, që kryesisht kanë të bëjnë me:

(1) mungesën e valorizimit të punës së shoqatave të autorizuara; (2) shtrirja e ngushtë e ndihmës juridike falas më herët, dhe (3) kufizimi i çështjeve juridike për të cilat mund të kërkohet dhe të aprovohet ndihma juridike falas. FShHM-ja ka pasur rol kryesor në përfaqësimin e zhvillimit të debatit publik në të cilën ishin prezantuar propozim-amendamentet të përgatitur nga FShHM-ja dhe shoqatat e autorizuara. Pastaj ka vijuar tërheqje të Propozim-Ligjit nga MD për përgatitje të versionit të ri, në koordinim me sektorin qytetar. Prej atëherë janë zhvilluar dy takime me MD në të cilat janë prezantuar dokumente me tekst të spastruar të Ligjit, propozim-modele për financim të shoqatave, si dhe sqarim të modelit për financim me konkurs publik.



- Përveç përfaqësimit për LNLF të ri, FShHM-ja në mënyrë aktive ka marrë pjesë në përgatitjen e ligjeve tjera dhe politikave që janë relevante për përforcimin ligjor, siç janë Ligji për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Diskriminimi, përfaqësimi për shkrirjen e suksesshme të qëllimit për zhvillim të qëndrueshëm 16.3 në ligjet kombëtare, analizë të gjendjeve në lidhje me përfaqësimin falas dhe

mënyrat alternative të zgjidhjes së kontesteve jashtë gjyqit. Për të avancuar shërbimet falas të avokatëve, sipas metodologjisë paraprake të zhvilluar, ishin hartuar dhe promovuar dy publikime: "Raporti për mundësitë dhe perspektivat e ndihmës juridike falas në RM", dhe "Analiza e zbatimit të mekanizmave për zgjidhje alternative të kontesteve dhe sigurimi i qasjes në drejtësi për kategoritë e cenuar në RM".

- përveç aktiviteteve të theksuara për zhvillimin e politikave të caktuara, në drejtim të mbështetjes së procesit të institucionalizimit të përforcimit ligjor ishin zhvilluar dy konferenca ndërkombëtare, një në Shkup dhe tjetra në Moldavi, në bashkëpunim me kolegët e Fondacionit në atë vend. Përveç kësaj, me qëllim të përfitimit të njohurive përkatëse, FShHM-ja ka mundësuar pjesëmarrje në kurs të specializuar për përforcim ligjor, që zhvillohet çdo vit në Universitetin Qendror Evropian në Budapest, me përfaqësues të MD dhe MPPS.

- Ishte zbatuar edhe një fushatë për përforsimin ligjor me qëllim që koncepti për përforsim ligjor që promovohet dhe të afrohet tek institucionet dhe publikut më të gjerë. Fushata ishte e suksesshme, me arritje të % të popullatës së plotë. Në kohën e njëjtë, ishte vendosur edhe internet faqja tematike www.pravnozajakni.mk me këshilla ligjore, informacione si dhe me të dhëna për organizatat qytetare që sigurojnë ndihmë falas ligjore dhe para-ligjore.



Aktivitetet e qëllimit të dytë specifik, që ka të bëjë me **sigurimin e qëndrueshmërisë së formave të ndryshme të qasjes në drejtësi**, janë lidhur me realizimin e aktiviteteve të qëllimit të parë. Përfaqësimi për LNJK të ri është drejtuar edhe drejt buxhetimit të ndihmës juridike falas që e sigurojnë shoqatat e autorizuara, që nga ana tjetër, në mënyrë të drejtë ndikojnë mbi qëndrueshmërinë e mbështetjes ligjore që e sigurojnë këto shoqata. Gjithashtu, me sistematizimin e ri dhe përfshirjes së ndihmës para-ligjore në QIR, MPPS ka siguruar mjete nga buxheti për këtë lloj të qasjes në drejtësi në nivelin kombëtar. Aktivitetet për përfshirjen e qasjes në drejtësi në politikat lokale - planet lokale të veprimit për integrim të romëve dhe grupeve tjera të cenuar - janë bazë përdorimin e mundësive që ofron Ligji i ri për Mbrojtje Sociale, që do të hyjë në fuqi në vitin 2019. Me këtë ligj është parashikuar që komunat të sigurojnë shërbime sociale me mjete financiare nga buxheti qendror që do të jepen me anë të procedurës së thirrjes publike, gjatë së cilës procedura do të zbatohet në bazë të programeve lokale të komunave. Janë dhënë nëntë grante për financim inventiv, me qëllim të sigurimit të qëndrueshmërisë financiare të modeleve të ndryshme të qasjes në drejtësi. Në vitin 2019, organizatat do të punojnë në gjetjen e mënyrave inventiv për financim të shërbimeve të tyre. Grantet janë rezultat i trajnimit të zbatuar për financim inventiv të synuar për njëzet organizatat e rrjetit joformal të përforsimit ligjor. Gjatë vitit 2018 në vazhdim janë mbledhur të dhëna për shpenzimet e kostot të tre formave të ndryshme të qasjes në drejtësi. Nga kontrolli i të dhënave mund të arrihet në konkluzion që shpesh shpenzimet e paraqitura nga ana e grupeve të cenuar të qytetarëve në lidhje me qasjen në drejtësi janë: shpenzime për transport, shpenzime për nisje të procedurës gjyqësore dhe shpenzime administrative. Qëllimi nuk është të tregohet nëse njëra formë e ndihmës juridike kushton më pak ose më shumë, por më tepër të bëhet një vlerësim i shpenzimeve aktuale për sigurimin e shërbimeve, të theksohet kush i mbulon këto shpenzime dhe të vlerësohet cilat shpenzime duhet të mbulojë shtetit për të siguruar qasje efektive në drejtësi.

Sigurimi i furnizimit të vazhdueshëm të shërbimeve cilësore ligjor edhe përforcimi ligjor i grupeve të qytetarëve të varfër dhe të marginalizuar (romët, punëtorët seksual, personat që përdorin droga dhe punëtorët e tekstilit) është qëllimi i tretë specifik që realizohet me anë të katër formave të qasjes në drejtësi të bazuar në komunitetin: ndihmë para-ligjore; ndihmë ligjore në komunitet; ndihmë falas juridike sipas LNFJ, dhe klinikë ligjor për grupet e cenuar.

FShHM-ja mbështet dyzet organizata qytetare që gjatë vitit 2018 kanë punuar në:

- Sigurimin e ndihmës ligjore dhe para-ligjore për më tepër se 2.000 romë në tetë komunitete romë, edhe atë në lidhje me: të drejtat e pacientëve, diskriminimi, pagesa e paligjshme për shërbimet shëndetësore, sigurimi shëndetësor dhe social, dokumentimi personal, ndihma sociale, ndihma dhe kujdesi nga personi tjetër, shëndeti reprodutiv, etj. Përveç kësaj, janë nisur tre raste për gabime të identifikuar mjekësore në formë të përfaqësimit strategjik. Në gjashtë komuna, me anë të vizitave në teren, paraligjorët sigurojnë informim sistematik për të drejtat dhe mundësitë e fillimit të ndihmës para-ligjore, identifikimin e problemeve ligjore dhe monitorim të vazhdueshëm i shkeljeve individuale të drejtave të njeriut. Janë zhvilluar tridhjetë punëtori edukative në temat vijuese: imunizimi; të drejtat e pacientëve; sigurimi shëndetësor dhe social, mbrojtja shëndetësore dhe kontrollet shëndetësore fala; programe për mbrojtje parandaluese shëndetësore; shëndeti i femrave; shërbime nga shërbimet patronazhe; planifikimi i familjes; martesat e adoleshentëve, etj. Si forma të veçanta të mobilizimit të komuniteteve të romëve për pjesëmarrje në përforcimin ligjor, a.q. Parlamenti Qytetar Rom dhe Iniciativa e Romeve nga Shuto Orizare kanë vazhduar me aktivitete edhe në vitin 2018. Për të theksuar është përfaqësimi i suksesshëm i Iniciativës së Romeve para Komitetit për Eliminim të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave, për të cilën ishte parashtruar një raport në hije me fokus në pagesën e paligjshme të gjinekologëve amë, mungesa e gjinekologëve amë në komuna, mungesa e vizitës së grave shtatzënë nga ana e motrave patronazhe si dhe nevoja për punësim të mediatorëve shëndetësor rom. Pas zhvillimit të seancës së shtatëdhjetë e një, Komiteti ka dalë me rekomandime para shtetit: të sigurohet shëndet cilësor dhe në dispozicion dhe planifikim të familjes dhe shërbime për shëndet seksual dhe reprodutiv; të merren masa për të ndaluar stigmatizimin dhe paragjykimet ndaj grave romë; të integrohen mediatorët shëndetësor rom në sistemin e mbrojtjes së shëndetit publik; dhe të ndalohen dhe të eliminohen praktikatat e pagesave të paligjshme për shërbime publike, posaçërisht për gratë romë që jetojnë në mjediset rurale, gratë me nevoja të posaçme dhe gratë migrante dhe refugjatë.
- Sigurimi i Ndihmës Juridike Falas (NJF), me anë të pesë shoqata të autorizuara, për rreth 1.100 qytetarë, më të shumti në fushën e mbrojtjes sociale, relacioneve në familje, relacionet pronësore-ligjore, mbrojtjes së fëmijëve dhe mbrojtjes së viktimave të dhunës familjare. Pesëdhjetë e pesë qytetarë kanë parashtruar kërkesa për NJF në MD për avokat falas që do të përfaqësojë në gjykatë, ndërsa

në dhjetë raste janë nisur procedura para Gjykatës Administrative për shkak të refuzimit të kërkesës për NJF. Janë zbatuar 21 seanca për përforsim ligjor, në të cilat qytetarët janë njoftuar me të drejtat e tyre dhe obligimet nga fusha e mbrojtjes sociale, relacioneve të punës, urdhër pagese noteriale, përmbarimi dhe të drejtat dhe obligimet e personave me detyrimeve në procedurë, dhuna e bazuar në gjini dhe familje, relacionet trashëgimore-ligjore dhe mbrojtja e fëmijëve.

- Organizimi i vazhdueshëm i trajnimeve të synuar për para-ligjorët që sigurojnë ndihmë para-ligjore dhe mbështetje për grupe të ndryshme të cenuar të qytetarëve (romët, punëtorët seksual dhe punëtorët e tekstilit) në bazë të Manualit për Edukim të Para-Ligjorëve. Janë zbatuar dy trajnime për para-ligjorët, në të cilat janë transferuar informacione themelore për fushat: ndarja e pushtetit, burime të drejtës dhe struktura e gjykatave në vendin tonë; bazat e procedurës gjyqësore qytetare; veprimi i policisë, prokurorisë publike dhe gjykatat penale; e drejta familjare dhe trashëgimore; dhuna familjare, dhe shqetësimi në vendin e punës. Në trajnimet kanë marrë pjesë 30 para-ligjorë që sigurojnë çdo lloj të ndihmës dhe mbështetjes për komunitetet e margjianizuar.

- Përgatitja dhe zbatimi i trajnimit treditör për organizatat qytetare që punojnë në avancimin e shëndetit dhe qasjes në mbrojtje shëndetësore për romët e Maqedonisë dhe të rajonit të Evropës Qendrore dhe Juglindore, në bazë të qasjes së integruar të llogaridhënies dhe përforsimit ligjor të komuniteteve romë. Në trajnimin ishin përpunuar temat vijuese: metodologji të llogaridhënies



sociale (monitorimi i komunitetit, revizioni social dhe monitorim dhe analizë të buxheteve), përforsimi ligjor dhe sigurimi i ndihmës para-ligjore, procesi i bashkimit të koncepteve të llogaridhënies sociale dhe përforsimit ligjor. Njëherë, në trajnimin ishin shkëmbyer përvoja nga puna e organizatave të gjitha vendeve. Trajnimi ka pasur për qëllim të përforsojë kapacitete e organizatave qytetare që punojnë në avancimin e shëndetit të romëve për zbatimi ne metodologjive të përmendur lartë.

- Sigurimi i shërbimeve të vazhdueshme para-ligjore për punëtorët seksual në Maqedoni nga ana e tetë para-ligjorëve nga Shkupi, Ohri, Struga, Strumica dhe Gostivari. Gjatë vitit, para-ligjorët kanë realizuar 613 vizita/kontakte me 176 punëtorë seksual të ndryshëm edhe atë 242 kontakte në Shkup, 59 në Gostivar, 110 në Strumicë, 78 në Strugë dhe 124 në Ohër. Pjesa më e madhe e shërbimeve të dhëna kanë të bëjnë me informacione dhe këshilla në fushën e dhunës

familjare; dhuna psikike, fizike dhe seksuale nga ana e klientëve, familja dhe policia; mbrojtja nga diskriminimi dhe realizimi i të drejtave për mbrojtje shëndetësore dhe sociale. Në 154 raste, pra-ligjorët i kanë drejtuar punëtorët seksual për këshillim të mëtutjeshëm dhe mbështetje, shpesh në shoqatat që ofrojnë shërbime (punëtorët social, psikologët/terapeutët, juristët ose punëtorët shëndetësor). Janë realizuar 97 shoqërime në polici, ishte siguruar përfaqësim gjyqësor në rast të: diskriminimi i personave që përdorin droga; fëmijët e punëtorëve seksual, viktimat e dhunës dhe diskriminimit racor; urrejtja ndaj trans-personave që në kohën e njëjtë janë edhe punëtorë seksual. Janë në procedurë gjashtë raste gjyqësore për njohje ligjore të gjinisë (një prej këtyre rasteve është nisur para Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe për atë pritet rezultat pozitiv). Për 97 persona që përdorin droga janë siguruar më tepër se 746 shërbime ligjore, në të cilën janë përfshirë edhe personat e dalë nga burgu që nuk posedojnë dokumente për identifikim personal, sigurim shëndetësor dhe trajtim përkatës pas daljes nga burgjet, si dhe njëmbëdhjetë shërbime ligjore për familjet e përdoruesve të drogave.

- Sigurimi i 350 shërbimeve para-ligjore dhe 392 shërbime ligjore për punëtorë të tekstilit dhe punëtore të 82 fabrikave të tekstilit. Ishte nisur një procedurë strategjike për largimin e pabazë të një punëtore të tekstilit, që është edhe angazhuar si para-ligjore. Më tutje, janë zhvilluar dhjetë vizita monitorimi në Koçanë, Makedonska Kamenica, Probishtip, f. Podlog, Obleshevë, Çeshinovë dhe Dellçevë, në të cilat kanë marrë pjesë 52 punëtore të tekstilit. Për të informuar punëtoret, por edhe opinionin, për numrin e këshillave të siguruara ligjore dhe para-ligjore, janë përgatitur dhe publikuar katër info-grafikonë për shkelje të denoncuar të drejtave të punëtorit të punëtorëve të tekstilit. Janë fituar pesë mendime pozitive nga Inspektorati Shtetëror i Punës pas nisjes së procedurave në të cilat janë konstatuar shkelje të drejtave të punëtorit dhe janë dhënë rekomandime për punëdhënësit për largimin e shkeljeve, që i kanë zbatuar rekomandimet. Shkeljet kanë të bëjnë me lëshimin e kalkulimeve të rrogave, punës jashtë orarit dhe pagesës së regresit për pushimin vjetor (K15). Pesë konfeksionet për të cilat janë nisur procedura dhe janë marrë mendime pozitive punësojnë rreth 1.100 punëtore, që do të thotë se ata kanë pësuar fitime dhe ndryshime pozitive si rezultat i vëzhgimeve të inspektorëve. Këto raste i kanë zbuluar para-ligjorët që kanë përgatitur kërkesat për vëzhgimin e inspektorëve.
- Ishte formuar një ekip i dyzet studentëve që në vitin shkollor 2018/19 do të angazhohen në kuadër të Klinikës Juridike për Grupet e Cenuar pranë Fakultetit Juridik "Jusitiani i Parë". Profesorët-mentorë që do të punojnë me studentët kanë hartuar katër plane, edhe atë në fushat vijuese: Të drejtat e kategorive të cenuar konsumatorë, të drejtat e mbrojtjes sociale dhe shëndetësore, të drejtat e familjeve të personave të burgosur dhe personave të paraburgosur, dhe e drejta administrative, në të cilat janë përmbajtur qëllimet dhe programi për secilin trajnim në veçanti. Janë zhvilluar dy trajnime në temën "Mbrojtja Sociale

dhe Shëndetësore” dhe një trajnim në temën “Procedura Administrative dhe Procedura para Avokatit të Popullit”.

KONCEPTI: QYTETARËT PËR ARDHMËRINË

Në vitin 2018, FShHM-ja ka siguruar **mjete plotësuese nga fondi rezervë për Fondacionet e Shoqërisë së hapur** për zbatimin e konceptit Qytetarët për të Ardhmen. Duke njohur mundësinë historike pas nënshkrimit të marrëveshjes me Maqedonisë dhe Greqisë për zgjidhjen e kontestit të emrit, si dhe pas marrjes së rekomandimit të kushtëzuar nga BE-ja për fillimin e negociatave në qershor të vitit 2019 dhe ftesa e fituar për aderim në NATO, FShHM-ja në bashkëpunim me dhjetë organizata qytetare ka zbatuar fushatë të integruar për informim të qytetarëve mbi përfitimet nga integrimi i Maqedonisë në BE dhe NATO. Në këtë mënyrë, iniciativa kishte për qëllim të kontribuojë për dalje më të madhe dhe informim më të gjerë të qytetarëve për referendumin në shtator të vitit 2018. Më konkretisht, iniciativa ka kompensuar vendet e zbrazët potenciale, duke ju mundësuar shoqërisë progresive qytetare dhe qytetarëve të shprehin qëndrimet e tyre për ardhmërinë e vendit me anë të fushatës së strukturuar për informim qytetar që do të theksojë nevojën dhe përfitimet e integritit euroatlantik të Maqedonisë. Aktivitetet i zbaton FShHM-ja dhe dhjetë organizata partnere (*CIVIL* – Qendra për Liri, *Koalicioni Rural* – Kumanovë, *Eurothink* – Qendra për Strategji Evropiane, Komiteti i Helsinkit për të Drejta të Njeriut të RM-së; Shoqata për Emancipim, Solidaritet dhe Barazi të Grave - *ESE*; Qendra për Arte Bashkëkohore, *OJQ Infocentar*, *HERA* - Asociacioni për Edukim Shëndetësor dhe Hululumtim, dhe Forumi Rinor *Arsimor*), *TV 24Vesti* dhe individë të përfshirë.

Në gusht dhe në shtator ishin përgatitur analiza krahasuese për përfitimet dhe mangësitë e aderimit në BE dhe NATO në fushat e ekonomisë, bujqësisë dhe shëndetësisë, dhe ato kanë përmbajtur të dhëna nga shtetet fqinje që janë aderuar së fundi në BE. Për fushat e arsimit, mjedisit jetësor, sundimi i të drejtës, të drejta të njeriut dhe antikorrupsioni ishin përgatitur fakte dhe të dhëna që sigurojnë informacione relevante për përfitimet dhe mangësitë e aderimit në BE dhe NATO, dhe ishin krijuar edhe përmbajtje me pyetje më shpesh të parashtruar për EU dhe fakte për NATO. Marrëveshja mes Maqedonisë dhe Greqisë ishte lëndë e analizës, me qëllim që në aspektin historik të sqarohen dhe zërthehen dispozitat e marrëveshjes dhe çështjet për identitet që janë të rëndësishme për opinionin e gjerë, me çfarë do të ulet frika tek qytetarët.

Analizat kanë shërbyer si bazë për përgatitjen e fakteve të shkurta dhe kyçe për secilën prej fushave të zgjedhura, duke siguruar një sqarim të lehtë të përfitimeve nga anëtarësimi në BE dhe NATO. Këto fakte ishin kthyer në zgjedhje kreative, në gjuhën maqedonishte dhe shqipe, dhe kanë përfshirë pyetje dhe përgjigje për integrimin euroatlantik. Të gjitha zgjidhet kreative ishin pjesë e fushatës së integruar me titullin "Ec përpara! Zgjedhja është e jotja".

Fushata mediatike ishte zbatuar në periudhën para referendumit, prej 10 deri 27 shtator, dhe ishte përbërë nga një sërë aktivitete publike dhe mediatike që zhvilloheshin në nivelin kombëtar, duke përfshirë edhe materiale të ndryshme audio-vizuale të shpërndarë tek disa kanale të komunikimit, debate, promovime të librave si dhe takime me qytetarët. Ishte përgatitur edhe internet faqja zacekorinapred.mk që ka paraqitur një vend ku qytetarët kanë mundur të informohen dhe të marrin përgjigje të shumë pyetjeve në lidhje me integrimin euroatlantik dhe me marrëveshjen maqedonase-greke.



Ishin përgatitur pesë video në gjuhën maqedonishte (për bujqësi, arsim, shëndet, mjedis jetësor dhe për Marrëveshjen) dhe katër video në gjuhën shqipe si dhe nëntëmbëdhjetë animacione në gjuhë maqedonishte dhe tetë në gjuhën shqipe, që kanë përfshirë përfitimet kryesore në fushën e bujqësisë, arsimit, shëndetit, mjedisit jetësor, integritit në BE dhe NATO, sundimi i së drejtës, të drejtat e njeriut, antikorrupsioni dhe Marrëveshja. Këto materiale ishin shpërndarë në pesë TV stacione kombëtare dhe katërmëdhjetë lokale me gjithsej 903 transmetime gjatë kohës së fushatës. Për fushat e njëjta ishin përgatitur edhe njëmbëdhjetë klipe në radio në gjuhën

maqedonishte dhe nëntë në gjuhën shqipe, që ishin shpërndarë në dy radio stacione kombëtare dhe pesë lokale, me gjithsej 504 transmetime gjatë kohës së fushatës.

Për të fituar më tepër dukshmëri në fushë, si pjesë e fushatës ishin krijuar gjashtë zgjidhje kreative për bilbordë me disa rekomandime kyçe për çështjet lidhur me identitetin, gjegjësisht zberthimin e marrëveshjes, përfitimet nga partneriteti me NATO si dhe disa përfitime nga integrimi në BE.


Një e ekip i përzgjedhur i gazetarëve ka përgatitur dy edicione të gazetës qytetare "Eureka" që ishin synuar për publikun që nuk përdor medie sociale, por mundeshin të gjenden edhe në internet. Gazeta ka përdorur materialet e prodhuara në fushat e përzgjedhura, që ishin të përpunuar më tepër në formë të teksteve gazetareske. Edicioni i parë i gazetës ka përmbajtur versionin e plotë të Marrëveshjes mes

Maqedonisë dhe Greqisë. Dy edicionet e gazetës ishin shtypur në tirazh prej 55.000 kopje (45.000 kopje në maqedonisht dhe 10.000 kopje në shqip) dhe ishin shpërndarë qytetarëve në vende të ndryshme në Shkup, Veles, Shtip, Manastir, Prilep, Kumanovë, Strumicë, Dellçevë, Tetovë, Gostivar, Ohër, Gjevgjeli, Negotinë, Berovë, Strugë, Koçan, Kavadar, Dibër dhe Kërçovë. Në mediat sociale (Facebook, Instagram, Twitter and YouTube) fushata ka pasur 3.1 milion shikime dhe 81.000 bashkëveprime.

Një pjesë kyçe e fushatës ishin ngjarjet publike të organizuar në bashkëpunim me TV 24Vesti kombëtare, me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të shoqërisë qytetare, ekspertë të fushave të ndryshme tematike dhe krijues të mendimit publik. Ishin organizuar gjashtë emisione debative "Otvoreno" në qytete të ndryshme të Maqedonisë (Shtip, Strumicë, Manastir, Tetovë, Kavadar dhe Shkup) rreth çështjeve të lidhura me integrimin në BE dhe NATO, marrëveshja, ekonomia, bujqësia, etj. Debatet "Moj Termin" gjithashtu kanë përfshirë çështjet e shëndetësisë, të rinjtë dhe arsimin, sundimin e të drejtës, gjatë së cilës ekspertët e shoqërisë qytetare dhe nikoqiri kanë pasur mundësi të komunikojnë drejtë me qytetarët dhe të përgjigjen pyetjeve lidhur me temën.

Organizata partnere CIVIL – Qendra për Liri, në bashkëpunim me ekspertë të dalluar të shumë fushave, ka hartuar disa artikuj me të cilat ishin hapur shumë diskutime në opinion për tema dhe çështje lidhur me referendumin dhe me integrimin euroatlantik të Maqedonisë.

Forumi Rinor Arsimor ka përpiluar dy video informative, edhe atë një video kuiz "Sa dinë për BE?" dhe një video informative me titullin "Informohu! Vendos! Voto!", që në mënyrë të thjeshtë dhe të qartë ishte sqaruar se çfarë mund të bëjnë të rinjtë për të marrë informacione të gjera lidhur me referendumin dhe rëndësinë e këtij referendumi, dhe ishte theksuar edhe rëndësia që të merret një qëndrim dhe të dilet në votime. Përveç kësaj, si pjesë e fushatës ishte organizuar edhe një debat "Mendo me Zë" në të cilën ishte diskutuar për çështjet më të rëndësishme për të rinjtë: arsim, papunësia e të rinjve dhe mundësitë për pavarësi financiare, por edhe për perspektivat e të rinjve që hap euro integrimi i Maqedonisë.



HERA – Asociacioni për Arsim Shëndetësor dhe Hulumtim ka përpiluar katër video për pushimin e prindërve nga puna, duke theksuar praktikat evropiane për këtë çështje, si dhe përdorimi i shërbimeve për kujdesin e fëmijëve.

Një pjesë e aktiviteteve të grantit për Komitetin e Helsinkit për të Drejta të Njeriut të Republikës së Maqedonisë kanë përfshirë nisje të bisedave mes intelektualëve

maqedonas dhe grek për Marrëveshjen, në bashkëpunim me Federatën Ndërkombëtare për të Drejta të Njeriut nga Athina dhe përkthim nga gjuha greke në maqedonishte të librit "10+1 Pyetje dhe Përgjigje për Çështjen Maqedonase" nga Kostis Karpozilos dhe Dmimitris Hristopulos. Në promovimin dhe debatin në Shkup, intelektualët maqedonas dhe grek kanë biseduar për qëndrimet dhe frikët e qytetarëve nga dy vendet që dalin nga marrëveshja e nënshkruar. Koalicioni Rural ka zhvilluar dhjetë debate publike me fermerët nga Komanova, Vallandova, Prilepi, Sveti Nikole, Strumica, Shtipi, Gostivari, Struga, Resnja dhe Manastiri, në të cilat ishte diskutuar për përfitimet dhe sfidat në bujqësi, si rezultat i aderimit në BE dhe NATO. Tre intervenimet artistike, të vendosur nga Qendra për Arte Bashkëkohore në vende të ndryshme, kanë synuar çështjet e krenarisë kombëtare, identitetit dhe ardhmërisë dhe kanë tërhequr vëmendjen e qytetarëve. Forumi Rinor Arsimor ka organizuar ngjarje publike në të cilat të rinjtë kanë pasur mundësi të shprehin mendimet e tyre dhe frikët për të ardhmen e vendit në BE dhe NATO.

Në vitin 2018 ka filluar edhe përgatitja e publikimit me titull pune "Nga Bukureshti në Prespë" që do të prezantojë gjendjet kryesore shoqërore në Maqedoni gjatë periudhës 2008-2019.

**ARRITJE KRYESORE DHE/OSE AKTIVITETE QË KANË
DALLUAR PUNËN E ORGANIZATAVE QË MBËSHTETUR
NË KUADËR TË FUSHAVE STRATEGJIKE TË FSHHM-SË
NË VITIN 2018**

FUSHA: ANGAZHIMI I TË RINJVE

Forumi Rinor Arsimor

Në vitin 2018 mbështetja e Forumit Rinor Arsimor (FRA) në kuadër të fushës *Angazhimi Rinor*, ishte drejtuar drejt dy qëllimeve, edhe atë: **(1)** avancimi i arsimit për krijimin e qytetarëve aktiv me anë të programeve arsimore për shkollat e mesme, me përfshirje të aktiviteteve për debate dhe drejtësi në shkollat, si dhe monitorim të arsimit dhe format për të rinj, dhe **(2)** mbështetja e aksioneve rinore për aktivizëm lokal, liri të informimit dhe shprehjes.

Në kuadër të qëllimit të parë, FRA ka siguruar një program për arsim joformal, me anë të udhëheqjes së 57 klubeve për *Debat*, *Mësojmë të Drejtën* dhe *Media/Art* në shtatë qytete, në të cilën mbi 400 të rinj ishin anëtarë dhe kanë ndjekur ligjërata javore. Në bashkëpunim me organizatat arsimore, një pjesë e klubeve për të rinj janë realizuar brenda shkollave: DUCOR "Partenie Zografski", SUGS "Shaip Jusuf", SUGS "Zef Lush Marku", SUGS "Saraj", SUGS "Orde Çopella" dhe tjerë. Ishin organizuar Turne Kombëtare për Debate për nxënësit e shkollave të mesme dhe Turne të ekipeve të përziera të debatuesve-amatorë, ndërsa debatues të FRA kanë marrë pjesë në Kampionatin Evropian të Debatit për studentë. Ishin organizuar katër simulime të gjykimeve dhe të punës së institucioneve, ishin organizuar vizita të komunave, gjykatave dhe Kuvendit të RM-së.

Me anë të pjesëmarrjes së përfaqësuesve të FRA në grupet e punës për Ligjin për të Rinj; organizimin e shkollave të mesme; organizimi studentor; strategjinë për bashkëpunim me diasporën dhe strategjinë për bashkëpunim dhe zhvillim të shoqërisë qytetare, FRA ka dhënë kontributin në zhvillimin e politikave të reja për të rinjtë, që do të garantojnë pjesëmarrjen e të rinjve. FRA-ja ka nisur dhe ka udhëhequr aksionin për përfaqësim të mbështetur nga nëntëdhjetë organizata, me të cilat ishte ndaluar miratimi i ndryshimeve të Ligjit për Tatim të Ardhurave Personale që mundeshin të dëmtojnë organizatat e të rinjve dhe ato qytetare.

Për realizimin e qëllimit të dytë, të rinjtë nga qytete të ndryshme kanë organizuar nëntë ngjarje me intervenime në hapësira publike për të zbuluar dhe rritur vetëdijen e komunitetit me anë të ekspozitave, rinovimit të parqeve, vizatimit të muraleve të Koço Racin dhe Goran Stefanovski, dhe aksione tjera. Ekipi i FRA ka përpiluar manuale për aktivizëm kreativ dhe qytetar, liri të shprehjes, aksione në hapësirë publike dhe shkrim/lexim mediatik, që përdoren për edukim më të mirë të anëtarëve. Gjithsej pesëdhjetë studentë dhe nxënës të shkollave të mesme kanë bërë vullnetarizëm dhe janë përfitur me përvojë në punë rinore, me anë të udhëheqjes së klubeve rinore.

Këtë vit, gazetarët e *Radio FRA* kanë fituar dy çmime: çmimin e dytë të konkursit "Vizioni për një Shkup Evropian" (nga Drejtoria për Kulturë dhe Art) dhe çmimin e parë për njoftim profesional mbi refugjatët (nga UNHCR, Shoqata Maqedonase e Juristëve të Rinj, Shoqata e Gazetarëve të Maqedonisë). Gjithsej 4.300 artikujt dhe lajmet e *Radio FRA* kanë pasur mbi një milion vizita, dhe ishin prodhuar 82 emisione në radio për arsim seksual, vullnetarizëm, aftësi të kufizuar, kulturë dhe tema tjera. Emisioni i vetëm në eterin maqedonas dedikuar arsimit "Në orë" ishte kontrolluar më tepër se 49.000 herë. Me ndihmën e ekipit të redaksionit, në përpilimin e emisioneve dhe përmbajtjeve ishin përfshirë 25 vullnetarë. 10 ngjarjet më të rëndësishme që kanë shënuar vitin 2018 ishin publikuar para fundit të vitit, me qëllim që edhe një herë të theksohet rëndësia e temave që i kanë mbuluar.

Në temën "Të Rinjtë dhe Shoqëria e Hapur", në kuadër të shënimit të 25 vjetorit të ekzistimit dhe punës së FShHM-së, FRA ka organizuar konferencën për aktivizëm shoqëror "ENGAGE" dhe debatin e natës Argument – shprehje e organizuar e tezës "Kjo shtëpi beson që shteti me këtë rini (nuk) duhet të kujdeset për ardhmërinë".



GRANTE TË ORGANIZATAVE QYTETARE

Në maj të vitit 2018, FShHM-ja ka shpallur thirrje publike për mbështetje të organizatave qytetare, me qëllim të mundësohet të rinjve të përgjigjen gjitha llojeve të ndarjeve në shoqëri dhe të kundërshtojnë modelet që e margjializojnë rolin e tyre. Thirrja ishte dizajnuar në dy tërësi, që për tërësinë e parë që ka synuar projekte që nxisin komunikim dhe bashkëveprim mes të rinjve nga rajone të ndryshme të Maqedonisë që janë pjesë të komuniteteve të ndryshme me anë të organizimit të kampeve dhe programeve për aktiviteteve ndërkulturore për të rinjtë, kanë arritur gjithsej 31 aplikacione dhe ishin mbështetur nga katër organizata. Për tërësinë e dytë që ka synuar për projekte që me anë të përdorimit të veglave inventive për identifikimin e të folurit të urrejtjes, njohje dhe përhapje të lajmeve të rrejme dhe të ndryshuar, si dhe mundësi për përballimin e tyre, kanë arritur nga dhjetë organizata, ndërsa grante ishin dhënë për dy prej tyre.

FUSHA: POLITIKA SHËNDETËSORE TË BAZUAR NË TË DREJTA

Fusha *Politika shëndetësore të bazuar në të drejta* është një prej prioriteteve strategjike të FShHM-së, që ka për qëllim afatgjatë avancimin e politikave shëndetësore të grupeve të marginalizuara (LGBTI, romët, personat që përdorin droga, punëtorë seksual dhe personat që jetojnë me HIV). Qëllimet e përgjithshme përfshijnë: **(1)** monitorimi dhe analiza e buxhetit shëndetësor dhe kërkimi i llogaridhënies së Qeverisë për shpërndarje të mjeteve maksimale që do të mundësojnë realizimin e të drejtave progresive dhe jo-diskriminuese shëndetësore; **(2)** përfaqësim për reforma në politikat shëndetësore, në përputhje me nevojat e komuniteteve, dhe **(3)** mundësimi i përfshirjes dhe pjesëmarrjes së komuniteteve të interesuara në planifikimin, monitorimin dhe vlerësimin e zbatimit të politikave shëndetësore.

Në drejtim të arritjes së qëllimeve, në vitin 2018 ishin dhënë grante institucionale Shoqatës për Emancipim, Solidaritet dhe Barazi të Grave – ESE, HOPS – Opsione për Shëndet të Shëndoshë Shkup, Koalicioni *Margini* dhe STAR-STAR, si dhe grante projekte për monitorim të buxheteve të programeve për uljen e dëmeve, për shoqatat që punojnë për ndryshimin e narrativëve negative ndaj romëve dhe shoqatave që punojnë në de-institucionalizimin e personave me pengesa intelektuale.

Shoqata për Emancipim, Solidaritet dhe Barazi të Grave – ESE

Shoqata për Emancipim, Solidaritet dhe Barazi të Grave – ESE punon në përmirësimin e realizimit të drejtave sociale dhe ekonomike të grupeve të cenuar të qytetarëve, përforsimin e tyre, mobilizmin dhe përfshirjen në planifikimin, zbatimin dhe vlerësimin e politikave dhe shërbimeve publike.

Në lidhje me planifikimin programor dhe buxhetor dhe zbatimin, në vitin 2018 janë përgatitur analiza të katër programeve të Ministrisë së Shëndetësisë që kanë të bëjnë me avancimin e shëndetit të nënave dhe fëmijëve dhe avancimin e shëndetit riprodhues të grave për vitin 2017 dhe 2018. Analizat përcaktojnë problemet kryesore dhe mangësitë dhe përfshijnë rekomandime për avancimin e këtyre programeve gjatë vitit të ardhshëm 2019, me theks të veçanti mbi rritjen e shtrirjes së grupeve të synuar të popullatës për të cilën janë hartuar këto programe. Analizat dhe rekomandimet janë dorëzuar tek ministri i shëndetësisë dhe ministri i financave. Përveç kësaj këto dokumente tregojnë gjendjet e përcaktuara dhe problemet në lidhje me shtrirjen e popullatës romë me mbrojtje parandaluese shëndetësore të nënave dhe fëmijëve dhe shëndetin riprodhues të grave, si dhe në lidhje me shtrirjen e aktiviteteve të parashikuara në programet parandaluese. Të dhënat për këtë segment janë fituar në bashkëpunim me organizatat partnere romë, me anë të qasjes së llogaridhënies sociale dhe pyetësorit për hyrje në amvisëritë romë në katër komunitat. Ishte zbatuar Strategji Kombëtare për Përfaqësim për avancimin e shëndetit dhe mbrojtjes shëndetësore të grave romë, me fokus të veçantë në nënat

dhe fëmijët dhe shëndetin riprodhues të grave, me të cilën kërkohet zbatimi i masave konkrete dhe aktivitete për avancimin e grave, nënave dhe fëmijëve të komunitetit rom me anë të një shtrirje më të gjer të mbrojtjes shëndetësore parandaluese dhe miratimit të masave dhe aktiviteteve në programet parandaluese të synuar për mjediset romë. Zbulimet dhe rekomandimet ishin arsyetuar në takimin me përfaqësues të kabinetit të ministrit të shëndetësisë. Përveç kësaj, ishin përgatitur deklarata për shtyp në të cilat janë prezantuar zbulimet kryesore dhe rekomandimet, dhe ishte organizuar një brifing për gazetarët për problemet dhe mangësitë e konstatuar të programeve që kanë të bëjnë me avancimin e shëndetit të grave dhe fëmijëve, me fokus të veçantë mbi popullatën romë. Zbulimet nga puna e ESE, bashkë me rekomandimet për avancimin e shëndetit të romëve, ishin prezantuar edhe në një punëtori të posaçme në kuadër të takimit të 12-të Platformës Evropiane për Inkluzion të Romëve, që ishte organizuar nga Komisioni Evropian në Bruksel.

Në drejtim të përmirësimit të shëndetit dhe qasjes në shërbime shëndetësore për gratë, nënat dhe fëmijët, ishte bërë një monitorim të buxhetit të plotë për avancimin dhe mbrojtjen e shëndetit riprodhues dhe notë për ndikimin e politikave makroekonomike të vazhdueshme mbi qasjen në mbrojtje shëndetësore dhe shërbime për nënat, gratë dhe fëmijët. Qëllimi i analizës është të përcaktohen ndikimet negative mbi sektorin shëndetësor me vendime të caktuara të Qeverisë në fushën e politikave makroekonomike dhe të përcaktohen buxhetet prej të cilat mund të shpërndahen mjete për shërbime shëndetësore për të avancuar shëndetin e grave, nënave dhe fëmijëve. Rezultatet e fituara janë prezantuar në një dokument të shkurtër për përfaqësim, që përmban edhe rekomandime për avancimin e pengesave të identifikuar. Ky dokument është dorëzuar tek Ministria e Financave, Qeveria e Republikës së Maqedonisë dhe Ministrisë së Shëndetësisë. Në kohën e njëjtë, në vitin 2018, me iniciativë të ESE është themeluar grup pune ekspertësh për përcaktimin e arsyeve për rritjen e vdekjeve perinatale dhe të foshnjave në Republikën e Maqedonisë. Me anë të punës së grupit të ekspertëve janë mbledhur të dhëna për gjendjet lidhur me vdekjen perinatale dhe të foshnjave dhe mendimet e ekspertëve të bazuar në përvojat nga puna e tyre për të cilën kanë përgatitur pesë analiza. Në bazë të dhënave të mbledhura dhe analizat eksperte, në janar 2019 do të përgatitet një analizë më e gjerë të gjendjeve dhe mundësive të arsyeve të rritjes së vdekjes perinatale dhe të foshnjave në Republikën e Maqedonisë gjatë viteve të fundit.

Gjatë vitit 2018, përfaqësues të ESE kanë marrë pjesë në grupin e punës së Ministrisë së Shëndetësisë për përgatitjen e Programit për Mbrojtje Aktive Shëndetësore të Nënave dhe Fëmijëve, gjatë së cilës është parashtruar kërkesë me propozim-masa, me theks të veçantë në grupet e cenuar (komunitetet romë dhe rurale). Me anë të pjesëmarrjes në takime të punës së misionit të organizuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Organizatës Botërore të Shëndetit, që ka pasur për qëllim të bëjë një vlerësim të uljes së vdekjeve të foshnjave, të avancohet shëndeti i grave gjatë shtatzënisë, si të avancohet shëndeti i fëmijëve, ESE ka prezantuar zbulimet nga

puna në këtë fushë, si dhe rekomandimet për përmirësim të gjendjeve. Gjithashtu, pjesëmarrja në misionin për reforma të mbrojtjes primare shëndetësore (të organizuar nga Ministria e Shëndetit dhe Organizata Botërore e Shëndetit) ka mundësuar prezantim të zbulimeve dhe rekomandimeve për shërbimin patronazh, gjinekologët amë dhe ekipet parandaluese për shëndet të fëmijëve nga shtëpitë e shëndetit. Në kohën e njëjtë, në kuadër të këtij misioni ishte përdorur mundësia për të prezantuar përpjekjet për kyçje të komunitetit në procesin e planifikimit, zbatimit dhe vlerësimit të shërbimeve primare shëndetësore, me theks të veçantë në grupet e cenuar të popullatës. Pritet që ky mision, që është ende në zbatim, të rezultojë me përgatitjen e dokumentit me rekomandime për reforma të mbrojtjes primare shëndetësore në mars të vitit 2019.

Për të gjetur zgjidhje sistematike për punën e papaguar për kujdes të personave me sëmundje të rëndë, në vitin 2018 është përgatitur një analizë statistikore e të dhënave të mbledhur me anë të anketës në teren për sigurimin e kujdesit për personat me sëmundje të rëndë në amvisëritë. Në përgatitje e sipër është përgatitja e raportit që do të tregojë në çfarë mënyre sigurimi i kujdesit ndikon mbi gjitha aspektet e individëve dhe familjeve që ato e bëjnë në shtëpitë e tyre, si dhe problemet me të cilat përballohen.

ESE në vazhdimësi punon në përf forcimin e kapaciteteve të organizatave qytetare në Maqedoni dhe në rajonin e Evropës Juglindore dhe Azi për zbatimin e metodologjive të llogaridhënies sociale (monitorim dhe analizë të buxheteve, monitorim në komunitet, revizion social). Në këtë drejtim ishin realizuar aktivitetet vijuese: trajnim njëditor për metodologjitë e llogaridhënies sociale (nëntë përfaqësues të dy organizatave qytetare); katër trajnime njëditore dhe mbështetje mentorimi për monitorimin dhe analizën së buxheteve (40 pjesëmarrës nga organizata që punojnë në uljen e dëmeve nga përdorimi i drogave në Mal të Zi, Bosnjë dhe Hercegovinë dhe Serbi) dhe një trajnim treditore për llogaridhënie sociale dhe përf forcim ligjor të organizatave qytetare që punojnë në avancimin e shëndetit dhe qasjen në mbrojtje shëndetësore për romët nga Maqedonia dhe nga Rajoni i Evropës Qendrore dhe Juglindore (37 pjesëmarrës nga tetëmbëdhjetë organizata qytetore nga Maqedonia, Bullgaria, Rumania, Hungaria dhe Sllovakia). Për të mbështetur përpjekjet për përfaqësim të organizatave të pacientëve për avancimin e qasjes së personave me sëmundje të rralla në terapi me kohë dhe përkatëse, ishte publikuar një analizë buxhetore e Programit për Kurim të Sëmundjeve të Rralla për vitin 2017. Përveç kësaj, ESE ka siguruar edhe ndihmë plotësuese teknike organizatës HOPS - Opsione për Jetë të Shëndoshë Shkup, për sigurimin dhe analizën e të dhënave për drejtimin e mjeteve të mbledhur me anë të akcizave për cigare, etil alkool dhe birrë dhe të transferuar në buxhetin e Ministrisë për avancimin e qasjes në shërbime shëndetësore.

Përveç për organizatat qytetare, ESE ka punuar edhe në ngritjen e kapaciteteve të institucioneve publike për përfshirje të organizatave qytetare dhe qytetarët në krijimin, zbatimin dhe monitorimin e rregullores ligjore, buxhetet dhe shërbimet. Me

anë të Planit Kombëtar të Veprimit pranë Partneritetit të Hapur Qeveritar 2018-2020, Qeveria e Republikës së Maqedonisë ka obliguar Ministrinë e Shëndetit dhe Agjencinë për Punësim të Republikës së Maqedonisë të pilotojnë zbatimin e metodologjive të llogaridhënies sociale, për të zbatuar monitorim dhe vlerësim të Programit për Mbrojtje të Popullatës nga HIV/SIDA dhe Planit Operativ të Masave Aktive dhe Shërbimeve për Punësim. Në këtë drejtim, në vitin 2018 ishin zhvilluar tre takime me përfaqësues të Ministrisë së Shëndetësisë në të cilat ishin prezantuar metodologjitë e llogaridhënies sociale (monitorim të buxheteve, monitorim në komunitet dhe revizion social) dhe janë caktuar fazat e zbatimit të pilotimit. Në takimet ishte akorduar që ESE të zbatojë një trajnim hyrës për metodologjitë në tetor 2018, të synuar për kuadrin e Ministrisë së Shëndetit që punon në koordinimin e programeve shëndetësore dhe për organizatat qytetare që punojnë në fushën e HIV/SIDA, si dhe moderojë punëtorin për krijimin e planit të aktiviteteve për zbatimin e metodologjive për llogaridhënie sociale. Në kërkesë të ministrisë, trajnimi dhe punëtorja janë shtyrë për vitin 2019. Përveç me Ministrinë e Shëndetit, procesi i njëjtë ishte realizuar edhe në Agjencinë e Punësimit të RM-së. Në takimin e zhvilluar me Agjencinë ishin prezantuar metodologjitë e llogaridhënies sociale në të cilat punon ESE dhe janë caktuar fazat e zbatimit të pilotimit në mars 2019.

Gjatë vitit 2018, ESE ka vazhduar me aktivitetet për ngritjen e vetëdijes së opinionin më të gjerë për rëndësinë e transparencës fiskale dhe nevojës për rritjen e nivelit të transparencës së institucioneve publike me anë të sigurimit të informacioneve, materialeve edukative dhe video në kuadër të fushatës "Transparenca Fiskale në Maqedoni" dhe atë në mediat sociale dhe në internet faqen tematike www.fiskalnatransparentnost.org.mk. Janë publikuar 310 informacione individuale dhe video, që kanë 289.703 shikime në mediat sociale, ndërsa përmbajtjet e publikuar në internet faqen kanë arritur 4.500 persona.

Në bazë të aktiviteteve të zbatuar për vlerësimin e transparencës pro aktive të institucioneve publike është përgatitur "Raport për nivelin e transparencës pro aktive për vitin 2017", që pasqyron gatishmërinë e 16 dokumenteve kryesore të buxhetit në internet faqet e 25 institucioneve publike. Institucionet publike, organizatat qytetare dhe mediat e përdorin këtë raport si burim relevant të informacioneve për prezantim të gjendjeve dhe avancimin e publikimit pro aktiv të dokumenteve programore dhe buxhetore, nisje dhe zbatim të reformave në sistemin publik në Republikën e Maqedonisë, si dhe marrja e hapave për rritje të numrit të dokumenteve dhe informacioneve që do të jenë të publikuar nga ana e institucioneve publike. Përveç aspektit pro aktiv, në vitin 2018 ishte vlerësuar edhe transparenca reaktive dhe ishte përgatitur "Raporti për nivelin e transparencës reaktive për vitin 2017", që pasqyron plotësimin e obligimeve të dalin nga Ligji për Qasje të Lirë në Informacione me Karakter Publik nga ana e 66 institucioneve. Para këtyre institucioneve janë zbatuar 1.338 procedura për qasje të lirë në informacione me karakter publik. Këtë raport gjithashtu, institucionet publike, organizatat qytetare dhe mediat në nivelin kombëtar e përdorin si burim relevant të informacioneve për prezantim të gjendjeve dhe avancimin e veprimit të institucioneve publike sipas Ligji për Qasje të Lirë në

Informacione me Karakter Publik, nisje dhe zbatim të reformave në sistemin publike të Republikës së Maqedonisë, si dhe për ndërmarrje të hapave për avancimin e veprimit të institucioneve publike në procedurat për qasje në informacione me karakter publik. Për të siguruar vazhdimësi në avancimin e institucioneve publike në zbatimin e Ligjit për Qasje të Lirë në Informacione me Karakter Publik, në vitin 2018 ishin zbatuar 1.230 procedura për kërkesë të informacioneve me karakter publike para 86 institucioneve publike dhe ishin nisur 233 procedura ankimi. Gjatë vitit, ishte vazhduar edhe me monitorimin e zbatimit të 2.753 procedura për prokurime publike nga ana e 62 institucioneve shëndetësore në periudhën 2016-2017, për të cilën është përgatitur propozim-raport për avancimin/zmbrapsjen e punës së institucioneve në këtë fushë.

Për të avancuar niveli i transparencës fiskale, janë marrë aktivitete për përfaqësim me propozimin e zgjidhjeve për avancim të gjendjeve. Përveç zgjidhjeve të propozuar, ESE ka monitoruar edhe zbatimin e masave të miratuara në lidhje me transparencën fiskale dhe qasjen në informacione. Në bazë të zbulimeve nga monitorimi i zbatuar për nivelin e transparencës reaktive dhe pro aktive të institucioneve publike, janë dorëzuar rekomandime për 91 institucion publik. Në vitin 2018, si rezultat i pjesëmarrjes aktive të ESE në përgatitjen e Planit Kombëtar të Veprimit pranë Partneritetit të Hapur Qeveritar për vitin 2018-2020, Qeveria e Republikës së Maqedonisë ka miratuar pesë masa të rekomanduara për avancimin e transparencës fiskale dhe qasjes në informacione me karakter publik. Përveç kësaj, si rezultat i pjesëmarrjes së vazhdueshme në grupe të përhershme të punës për transparencë fiskale dhe qasje në informacione në kuadër të procesit të Partneritetit të Hapur Qeveritar për vitin 2016-2018, me ndihmë teknike dhe mbështetje nga ESE, Ministria e Shëndetit ka përgatitur dhe publikuar raporte programore dhe buxhetore për njëzet programe parandaluese dhe kuruese shëndetësore dhe ka zgjedhur Programin për Mbrojtje të Popullatës nga HIV/SIDA për pilotim të metodologjive të llogaridhënies sociale. Në bashkëpunim me Komisionin për mbrojtjen e të drejtës për qasje në informacione me karakter publik, ishte promovuar video klipi për promovim të së drejtës për qasje në informacione me karakter publik në gjuhën maqedonishte, shqipe dhe atë të shenjave. Video klipi ishte transmetuar në nëntë TV stacione kombëtare dhe lokale. Si rezultat i përpjekjeve të plota për avancimin e funksionimit të sistemit fiskal në Republikën e Maqedonisë dhe avancimin e nivelit të transparencës fiskale, ESE ka marrë pjesë në takim me institucionet relevante në të cilën ka dorëzuar propozime për hartimin e sistemit elektronike për publikim të ndryshimeve aktuale të arkës.

HOPS – Opsione për Jetë të Shëndoshë Shkup

Gjatë vitit 2018, me anë të sigurimit të shërbimeve të nevojshme dhe përfaqësimit për zhvillimin e zgjidhjeve përkatëse sistemore, HOPS – Opsione për Jetë të Shëndoshë Shkup ka punuar në avancimin e të drejtave shëndetësore të grupeve të marginalizuara, kryesisht personave të përdorin droga, personat adoleshentë që përdorin substanca psikoaktive (SPA) dhe punëtorët seksual.

Për të siguruar lloje të ndryshme të shërbimeve në përputhje me nevojat e grupeve të marginalizuar, me anë të vizitave në teren të fëmijëve në rrugë (dy herë në javë) ekipet profesionale të HOPS kanë siguruar 2.064 shërbime sociale të personave që përdorin drogë dhe anëtarëve të familjes së tyre, dhe këto shërbime shpesh kanë të bëjnë me realizimin e të drejtës për sigurim shëndetësor dhe mbrojtje shëndetësore, ndihmë sociale dhe mbrojtje sociale, realizimin e kërkesave për dokumente personale, realizimin e të drejtës për kurim nga varshmëria, dhe ishte dhënë ndihmë materiale në formë të ushqimit, rrobave dhe lëndë higjienike. Përveç kësaj, punëtorët social kanë punuar në motivimin dhe shoqërimin e fëmijëve që përdorin droga gjatë vizitës së institucioneve shëndetësore dhe sociale dhe gjatë dërgimit tek ekipi juridik, për të siguruar trajtim shëndetësor. Gjatë kësaj, për shkak të përdorimit të tepërt të drogave dhe problemet e lidhura psikike, ishte siguruar shërbime spitali për dy vajza të vogla, por pasi që nuk ka program të specializuar për trajtim të fëmijëve dhe të rinjve, kurimi nuk është realizuar, ndërsa familjet dhe fëmijët nuk janë të motivuar për kursim me terapi simptomatike. Ishte evidentuar një rast i sulmit fizik nga të punësuar në kafeteri në qendrën e Shkupi, për të cilën është nisur procedurë ligjore.

Janë realizuar 722 kontakte me tridhjetë përdorues adoleshent të drogave (16 meshkuj dhe 14 vajza), gjatë së cilës janë evidentuar shtatë raste të reja. Në bashkëpunim me Ministrinë e Punës dhe Politikës Sociale, janë realizuar dymbëdhjetë punëtori edukative në Entin Publik për Kujdesin e Fëmijëve me Probleme Edukative- Sociale dhe Sjellje të Dëmtuar - Shkup, Shtëpinë për Fëmijë pa Prindër "11 Tetori" dhe SOS fshati për fëmijën për të përforcuar vetëbesimin e fëmijëve dhe të parandalohet përdorimi i drogave. Me anë të aktiviteteve interaktive dhe kreative, ekipi profesional i një psikologu dhe pedagogu kanë ndihmuar njëzet e pesë fëmijë të avancojnë shkathtësitë për vendosjen e lidhjeve pozitive me bashkëmoshatarët, si dhe me personat e moshuar, për zgjidhje të konflikteve pa dhunë dhe mospajtimeve, si dhe shkathtësi për njohje dhe pranimin e veçorive të ndryshme personale të tjerëve. Ishte themeluar partneritet me Ministrinë e Shëndetësisë për formimin e një grupi të punës për përgatitje të Programit për Kujdes të Plotë dhe Kurim të Adoloshentëve që përdorin SAP, gjatë së cilës ishte arritur konsensus rreth parimet themelore dhe qëllimet e këtij programi lidhur me modelet e kurimit dhe kujdesit që duhet të sigurojnë fëmijëve. Në bazë të programit të miratuar, në vitin 2019 pritet që të përgatitet një plan veprimi në të cilën do të ndahen kompetencat mes institucioneve përkatëse dhe do të parashikohen mjetet nga buxheti qendror për realizimin e programit. Sfidat në lidhmë me adoloshentët që përdorin droga ishin diskutuar në takimin me përfaqësues të Qendrës Evropiane për Monitorim të Drogave dhe Varshmërive që ishte zhvilluar në shtator 2018, gjatë së cilës ishte rënë dakord që kjo problematike të jetë pjesë e raportit vjetër që parashtron kjo agjenci. Për shkak të ndjeshmërisë dhe aspektit specifik të punës me fëmijë përdorues të SPA, në vazhdimësi zhvillohet kujdes për ngritjen e kapaciteteve të ekipit në teren. Përveç takimeve të rregullta me drejtuesin e programit, ata kanë marrë pjesë edhe në trajnime të ndryshme ndërkombëtare. Në vitin 2018, në bashkëpunim me Rrjetin Evropian të Organizatave për Aktivizëm dhe Lidhje me

Droga - YODA (*Youth Organization for Drug Action*), në sajë të projektit të përbashkët me programin Erasmus+, tre përfaqësues të HOPS kanë vijuar dy trajnime dhe kanë bërë vizita studimore në Varshava (për zhvillim të programeve për të rinj që përdorin SPA) dhe në Kiev (për programe në teren për të rinj).

Këtë vit janë vërejtur më tepër aksione policore dhe arrestime për posedim të drogave. Juristët dhe anëtarët tjerë të ekipeve të HOPS monitorojnë gjendjen dhe bëjnë përpjekje që të motivojnë klientët që të paraqesin raste në të cilat të akuzuar për vepra penale me droga, për të siguruar mbrojtje dhe për të kontribuar për përmirësimin e trajtimit të personave të varur nga droga dhe të akuzuar për posedimin e drogës dhe për ndryshim të praktikës së kriminalizimit të tyre, në vend të ofrimit të trajtimit, rehabilitimit dhe re-socializimit. Ishte vërejtur që prania e avokatëve në procedurat policore në të cilat klientët hiqen nga liria për shkak të posedimit të SPA për përdorim personal mundëson që një numër më i vogël del me aktakuzë, gjegjësisht vetë prania e avokatëve kontribuon për ndryshimin e praktikave, gjegjësisht zbatimin e drejtë të ligjit në këto raste. Ekipi juridik ka siguruar gjithsej 746 shërbime ligjore dhe para-ligjore falas për 97 përdorues të drogave (12 femra dhe 85 meshkuj), njëmbëdhjetë shërbime ligjore për familjet e përdoruesve të drogave dhe 49 rom që përdorin droga. Përveç kësaj ishte siguruar përfaqësim strategjik para institucioneve kompetente vendore dhe të huaja për tetë persona para Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, edhe atë: Për pesë raste aktuale ka procedura për posedim të SAP për përdorim personal, mbrojtje nga dhuna mbi fëmijën nga një grua që përdor drogë dhe prezantim të rremë dhe diskriminim kundër personit që përdor drogë. Për tre raste të reja të evidentuar janë nisur procedura përkatëse, edhe atë për: shkelje të së drejtës së privatësisë së punëtorëve seksual për publikimin e incizimeve nga bastisja e vitit 2008, për viktimë të dhunës familjare dhe për rast të klientit që ka qenë viktimë e trafikimit me qenie njerëzore.

Tetë para ligjorë vazhdimisht kanë siguruar shërbime para ligjore për punëtorët seksual. Gjatë vitit, para-ligjorët kanë realizuar 613 vizita/kontakte me 176 punëtorë seksual të ndryshëm edhe atë 242 kontakte në Shkup, 59 në Gostivar, 110 në Strumicë, 78 në Strugë dhe 124 në Ohër. Pjesa më e madhe e shërbimeve të dhëna kanë të bëjnë me informacione dhe këshilla në fushën e dhunës familjare; dhuna psikike, fizike dhe seksuale nga ana e klientëve, familja dhe policia; mbrojtja nga diskriminimi dhe realizimi i të drejtave për mbrojtje shëndetësore dhe sociale. Në 154 raste, para-ligjorët i kanë drejtuar punëtorët seksual për këshillim të mëtutjeshëm dhe mbështetje, shpesh në shoqatat që ofrojnë shërbime (punëtorët social, psikologët/terapeutët, juristët ose punëtorët shëndetësor). Janë realizuar 97 shoqërime në polici, entet shëndetësore/qendrat metadone/gjinekologët, Fondin për Sigurim Shëndetësor dhe entet për mbrojtje sociale. Përveç këshillimeve, gjatë vizitave para-ligjorët kanë shpërndarë edhe kondome, lubrikantë dhe materiale informativë. Për të përforcuar kapacitetet e vetëpërfaqësimit dhe përforcimit ligjor të punëtorëve seksual, për gjithsej 67 punëtorë seksual, ishin organizuar gjashtëmbëdhjetë punëtori edukative, në tre cikle, në tema lidhur me dhunën familjare, ndërmjetësimi gjatë punës seksuale dhe përgjegjësia ligjore, si dhe modele

të mundshme për rregullimin e punës seksuale në Republikën e Maqedonisë. Me anë të një trajnimi dyditor, punëtorët seksual kanë avancuar shkathtësitë e tyre për sigurimin e ndihmës ligjore dhe para-ligjore në komunitet, me qëllim të njohin dhunën familjare dhe tjetër, shkelje të së drejtave lidhur me relacionet familjare, të drejtat e pacientëve, si dhe për realizimin e të drejtave sociale dhe shëndetësore. Përveç kësaj, janë zhvilluar trajnime për përforsim të komunitetit të punëtorëve seksual për realizimin e formave të ndryshme të aktivizimit qytetar, vetëpërfqësimit dhe mobilim të komunitetit, prezantim të komunitetit dhe kërkim i llogaridhënies nga institucionet publike.

Pas miratimit të përbërjes organizuese për dekriminalizimin e punës seksuale në Maqedoni, ishte formuar një grup i brendshëm i punësh që ka përcaktuar prioritet e mëtejme për përfaqësim, në bazë të analizës së problemeve, rrethinës dhe aktorët. Në vitin 2018 janë zhvilluar më tepër takime pune me Koalicionin *Margini*, Rrjetin për Përfaqësim të Drejtave të Punëtorëve Seksual (SWAN), STAR-STAR dhe përfaqësues të punëtorëve seksual, gjatë të cilës në prill ishte formuar koalicion nga partnerë me përpjekje të përbashkët për dekriminalizim. Ishte hartuar një plan i përbashkët për veprim me përgjegjësi të ndara mes partnerëve, përfshirë edhe sigurimin e mjeteve për aktivitetet e planifikuara. Ishte organizuar tryezë e rumbullakët për nevojën e avancimit të politikave kombëtare dhe praktikave për respektimin e të drejtave të njeriut, mbrojtjes nga dhuna dhe avancimi i sigurisë, shëndetit dhe varshmërisë ekonomike të punëtorëve seksual. Përfaqësues të komunitetit, institucionet shtetërore, sektorit qytetar dhe përfaqësues të opinionit profesional kanë debatuar për modele të mundshme të rregullimit dhe legalizimit të punës seksuale në RM. Në janar të vitit 2018, në partneritet me Shoqatën ESE si bartës dhe organizata tjera qytetare, para Komitetit për Eliminim të Gjitha Formave të Diskriminimit mbi Gratë (CEDAW, OKB Gjenevë) ishte përgatitur dhe dorëzuar informacion për gjendjen e punëtorëve seksual në Republikën e Maqedonisë. Pas dorëzimit të raportit në hije dhe takimet e punës të realizuar me krerët e Komitetit, për herë të parë Komiteti a dhënë rekomandim specifik që ka të bëjë me punëtorët seksual: ulja e dhunës mbi punëtorët seksual. Gjatë kësaj, nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë kërkon të merr masa me të cilat do të parandalohet, hulumtohet dhe persekutohet dhuna mbi punëtorët seksual dhe në mënyrë të drejtë do të ndëshkohen kryerësit e dhunës.



Gjatë vitit 2018, HOPS ka vazhduar punën në lidhje me politikat për buxhetimin e drejtë të programeve për uljen e dëmeve. Pas monitorimit të zbatuar për shpenzimin e të ardhurave buxhetore të realizuar nga akcizat e duhanit dhe alkoolit që janë të

lidhur me programet parandaluese për HIV, ishte përgatitur një analizë që përmban rekomandime që drejtë synojnë nevojat e njerëzve që përdorin droga dhe japin udhëzime për mënyrën e buxhetimit të aktiviteteve për uljen e dëmeve. Ishte planifikuar që analiza që printohet në vitin 2019 dhe të organizohet debat publik për prezantim të zbulimeve nga hulumtimi.

Përveç kësaj, HOPS ka realizuar shkollën e pestë për varshmëri "Droga, Politika dhe Praktika", në të cilën kanë marrë pjesë shtatëmbëdhjetë studentë nga fakultet e psikologjisë, punës sociale, mjekësisë, studimeve ligjore dhe siguri. HOPS ka marrë pjesë në punën e Komisionit Ndërmministror për Droga, në të cilën ka udhëhequr procesin e përgatitjes së Planit të Veprimit për Droga të Republikës së Maqedonisë 2018-2020. Në drejtim të sigurimit të qëndrueshmërisë së programeve për uljen e dëmeve, për përfaqësues të shtatë vetëqeverisjeve lokale ishte zhvilluar një trajnim treditör për ngritjen e kapaciteteve për krijimin e planeve lokale me financim të përfshirë të aktiviteteve për uljen e dëmeve. Në lidhje me punën mbi zhvillimin e politikave përkatëse për droga, magazina e specializuar "Droga, Politika dhe Praktika", përpilohet në mënyrë të rregullt.

Koalicioni Margini

Koalicioni *Margini*, si përfaqësues i një grupi të shoqatave, punon për promovim, përfaqësim, mbrojtje dhe kujdes për të drejtat e njeriut të bashkësie të marginalizuara, me qëllim që të realizojnë qasje të barabartë ndaj shërbimeve shëndetësore, sociale dhe juridike si dhe përfshirjen e tyre në të gjitha proceset e jetës shoqërore, nëpërmjet sigurimit të një mjedisi përkrahës në të cilin respektohen barazia, liria dhe dallimet.

Në vitin 2018, Koalicioni *Margini* vazhdoi punën e disa nismave ligjvënëse që janë të rëndësishme për bashkësitë e marginalizuara. Me qëllim që të sigurohet baza për përfaqësim për miratimin e Ligjit për Pranimin Ligjor të Gjinisë, janë përgatitur dy analiza, edhe atë: "Analiza krahasuese për praktikën më të mira të modeleve për pranimin ligjor të gjinisë" dhe "Analiza dhe rekomandimet për modelet dhe zgjedhjet e ndryshme të ligjvënies maqedonase për pranim të gjinisë në RM". Përfaqësimi ka përfshirë institucione të vendit dhe ndërkombëtare, kurse rezultatet e analizave u përdorën për përgatitjen e kontributit me shkrim të dërguar si shtojcë ndaj raportit të ri të Komisionit Evropian për progresin e vendit. Përfaqësuesja e Koalicionit *Margini* është anëtare e grupit të punës ndaj Ministrisë për Drejtësi, përgjegjëse për ndryshimin e Ligjit për evidentim amë dhe për gjetjen e modelit përkatës për pranimin ligjor të gjinisë. Duhet theksuar se në tërë procesin e përfaqësimit pjesëmarrje aktive kishin edhe përfaqësuesit e bashkësisë së personave transgjnorë. Përfaqësues i Koalicionit *Margini* zhvilloi intervista të hollësishme me 21 persona transgjnorë, prej të cilave u përpilua libri "Përvoja transgjnore: identitete, trupa, dhunë dhe socializim".

Koalicioni *Margini* është pjesë e grupit të punës për përgatitje të Propozim-ligjit për parandalim dhe mbrojtje nga diskriminimi, ku ka rol të rëndësishëm si koordinator i punës së Rrjetit për mbrojtje nga diskriminimi. Koalicioni ka përgatitur dhe shpërndarë tek të gjithë deputetët në Kuvend një dokument me argumente për miratim të ligjit të ri për parandalim dhe mbrojtje nga diskriminimi. Koalicioni *Margini* është një prej iniciatorëve për formimin e LGBTI grupit parlamentar ndër-partiak prej katërbëdhjetë deputetëve, qëllimi i të cilëve është promovimi dhe avancimi i të drejtave të LGBTI bashkësisë.

Me përvojën dhe njohurinë e vet, Koalicioni *Margini* në mënyrë aktive kontribuon edhe në Rrjetin kundër gjuhës së urrejtjes të nisur nga Misioni OSBE-së në Shkup. Veç kësaj, ajo iu bashkëngjiti nismës së Agjencisë për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale, Këshillit për etikë të medimeve dhe Shoqatës të Gazetarëve të Maqedonisë për miratimin e "Deklaratës për njoffim etik dhe profesional mbi temat lidhur me LGBTI". Deklarata përmban parime të njoffimit jostereotipik për LGBTI, përmbajtje nga/ gjykimi i gjuhës së urrejtës në bazë të orientimit seksual, identifikimit gjinor, njoffim mbi viktimat e dhunës dhe diskriminimit me empati dhe solidaritet, njoffim të paanshëm për aktivitet e LGBTI bashkësisë dhe aktivistëve për të drejta të njeriut në kuadër të fushës gjithëpërfshirëse shoqërorë, politike dhe kulturore, duke respektuar integritetin e tyre personal, mendimin dhe aktivitetet, si dhe parimet tjera profesionale të cilat gazetarët dhe mediat duhet të i respektojnë gjatë informimit të publikut.

Më tutje, në kontekst të promovimit të drejtpërdrejtë dhe avancimit të të drejtave të bashkësive të marginalizuara, Koalicioni *Margini* vazhdoi bashkëpunimin me më shumë institucione relevante, me qëllim që të përforcohen kapacitetet e nëpunësve shtetëror për punë me përfaqësues të bashkësive të marginalizuara. Në partneritet me Ministrinë për Punë dhe Politika Sociale, u avancua bashkëpunimi me Entin për veprimtari sociale, ku bashkërisht u plotësua dhe zgjerua Moduli 19 për punë me bashkësitë e marginalizuara. Pritet që Moduli 19 të bëhet pjesë e moduleve të domosdoshme në mënyrën e re të licencimit të punëtorëve profesional në sistemin për mbrojtje sociale, sipas Ligjit të ri për Mbrojtje Sociale, i cili duhet të miratohet në vitin 2019. Veç kësaj, në maj të vitit 2018 u zhvillua trajnimi për pesëdhjetë punëtorë profesional në sistemin për mbrojtje sociale për punë me bashkësitë e marginalizuara.

Me qëllim që të zhvillohen shkathtësitë dhe njohuritë për njohje, evidentim dhe ballafaqim me dhunën gjinore dhe dhunën moshatare në shkollat e mesme në bashkëpunim me Ministrinë për Arsim dhe Shkencë e RM-së, Koalicioni *Margini* organizoi trajnim për përfaqësues e shërbimeve profesionale t; shkollave, të cilët pastaj realizuan trajnime në tre shkolla të mesme në Shkup. Për nxënësit e këtyre shkollave u zhvillua edhe një shkollë dimërore për ballafaqim me dhunën moshatare. Veç kësaj, u realizua edhe një video-fushatë kundër dhunës gjinore dhe dhunës moshatare në shkolla.

Me qëllim që të avancohet praktika mjekësore në punën me personat e bashkësive të marginalizuara, u realizua bashkëpunimi me Shoqatën e Mjekëve Privat të Maqedonisë, ku u dorëzua kërkesë deri tek Oda e Mjekëve për akreditim të dy kurseve në kuadër të edukimi të vazhdueshëm të mjekëve (parandalim nga HIV dhe shëndeti i personave transgjnorë), që ritet të miratohet në janar të vitit 2019.

Gjatë vitit 2018, Koalicioni *Margini* ka dokumentuar 180 raste të të drejtave të shkelura të përfaqësuesve të bashkësive të marginalizuara, ku për njëmbëdhjetë raste ka përfaqësim strategjik pranë institucioneve të vendit dhe ndërkombëtare. Rastet e zhvilluara në vitin 2018 kanë të bëjnë me: procedurë qytetare për shpifje dhe ofendim për shkak të orientimin seksual të LGBTI aktivistit kundër pronarit të internet portalit / u dorëzua ankesë tek Gjykata e Apelit në Shkup kundër vendimit të shkallës së parë; procedurë qytetare për shpifje dhe ofendim për shkak të orientimin seksual të LGBTI aktivistit kundër radios / u dorëzua ankesë tek Gjykata e Apelit në Shkup kundër vendimit të shkallës së parë; procedurë qytetare e shkallës së parë kundër televizionit kombëtar për shkelje të së drejtës së privatësisë së dy punëtorëve trans-seksuale; përfaqësim në procedurë para Prokurorisë Themelore Publike për keqtrajtim gjatë kryerjes së shërbimit, ku është dëmtuar trans-grua; përfaqësim në procedurë para Prokurorisë Themelore Publike për keqtrajtim gjatë kryerjes së shërbimit, ku është dëmtuar person që përdor droga; përfaqësim në procedurë penale të personit që është kapur me kanabis; përfaqësim në procedurë penale për dhunë mbi dy aktivistë; përfaqësim i njëmbëdhjetë trans-personave para institucioneve të vendit dhe gjykatave në procedurë për pranimin ligjor të gjinisë; përfaqësimi i trans-personave para Gjykatës Evropiane për të Drejta të Njeriut për Shkelje të të Drejtës së Privatësisë për shkak të refuzimit të kërkesës për pranim ligjor të gjinisë; përfaqësim i dy personave që përdorin droga para Gjykatës Evropiane për të Drejta të Njeriut për Shkelje të të Drejtës së Privatësisë për shkak të marrjes së paligjshme të ADN mostrës, dhe përfaqësim të dy personave që përdorin droga para Gjykatës Evropiane për të Drejta të Njeriut për Shkelje të të Drejtës së Privatësisë për shkak të shkeljes së të drejtës së privatësisë në shpalosjen e të dhënave mjekësore.

Nën moton "E njëanshme. Politike", në qershor të vitit 2018 Koalicion *Margini* ishte bartës i javës së gjashtë të Javës së Krenarisë (Skopje Pride Weekend 2018), që u mbajt në më shumë vende në shumë. Nëpërmjet veprave artistike dhe performansave individuale dhe grupore dhe trans-artistëve të njohur (shkrimtarë, koreografë, artist vizuel, kant-autorë, DJ, etj.) nëpërmjet muzikës, kërcimit, teatrit, dramës, vizatimit, fotografisë, zërit, projeksioneve, instilacioneve, kostumografisë, dizajnit grafik dhe drag-artit prezantuan këndvështrimet e tyre për njëanshmërinë si dallim dominant në hapësirat dominante kulturore-politike.

Shoqata për mbështetje të punëtorëve të marginalizuar STAR-STAR

Me mbështetjen e programit tematik për shëndet publik pran Fondacionit Shoqëri e Hapur, FShHM i dha grant institucional Shoqatës për Mbështetje të Punëtorëve të Margjinalizuar STAR-STAR. Në partneritet me organizata tjera, STAR-STAR është përfshirë në mënyrë aktive në përfaqësimin e dekriminalizimit të punës seksuale në Maqedoni si dhe mbrojtjen dhe avancimin e të drejtave të njeriut të punëtorëve seksual. Shoqata punon në ndërtimin e kapaciteteve të punëtorëve seksual për vet-përfaqësim, boton botimet elektronike të revistës "S-Work", nëpërmjet cilës promovohet nevoja për përmirësim të statusit socio-ekonomik dhe shëndetësor të punëtorëve seksual dhe tradicionalisht çdo vit organizon Marshin e ombrellave të kuqe. Këtë vit motoja e marshit ishte "Dekriminalizimi tani!". Në vitin 2018, Shoqata zgjeroi aktivitetet e projektit nëpërmjet formimit të degëve lokale në Gostivar dhe Strumicë.

Ndryshim i narrativëve negativ ndaj Romëve në institucionet publike shëndetësore

Në bashkëpunim me programin tematik për shëndet publik ndaj Fondacionit Shoqëri e Hapur, përveç granteve institucionale në vitin 2018 FShHM siguroi mbështetje edhe për katër organizata qytetare për projekte nëpërmjet cilëve punohet në ndryshimin e narrativëve negativ ndaj Romëve në institucionet publike shëndetësore. Në kuadër të këtyre projekteve, dallohet zbatimi i aktiviteteve vijuese: dy debate publike lidhur me narrativet negative për Romët dhe (pa)barazisë dhe (mos)diskriminimit në praktikën shëndetësore; publikim i revistave me vizatime; promovim i tre videove të animuar dhe dymbëdhjetë video të shkurta në formatin "Shih Kështu".

Në tre komuna në rajonin e Bregallnicës u mbajtën tetë punëtori edukative në bashkësitë rome dhe u zhvillua hulumtim për ekzistimin e diskriminimit të fshehur ndaj pacientëve rom në institucionet shëndetësore, në bazë së cilës u mbajt panel-diskutimi.

Me qëllim që të përmirësohet komunikimi mes punëtorëve shëndetësor dhe pacientëve Rom, u mbajtën pesë punëtori të akredituara për njëqind punëtorë shëndetësor, dhe me qëllim që të nxitet shkrimi i artikujve gazetaresk inkluziv (përfshirës) dhe jodiskriminues, për gjashtëmbëdhjetë gazetarë dhe studentë të gazetarisë u mbajt punëtori për përmbajtje lidhur me kulturën, traditën dhe statusin shëndetësor të popullatës rome. Tre forum-teatrot mundësuan shfaqjen e situatave reale nga përvojat e romëve gjatë ndërveprimit të tyre me punëtorët shëndetësor. Në mediat sociale u shpallën gjashtëmbëdhjetë storie të shkurta të shkruara, gjashtë foto-tregime dhe dy video të shkurta, kurse për punëtorët shëndetësor u përgatitën dy buletine edukative.

Në bashkësitë rome në Prilep dhe në Manastir, me qëllim që të tejkalohen paragjykimet ndaj çështjeve të caktuara mjekësore, dhe me këtë të zvogëlohet edhe zbrazëtira në komunikimin mes romëve dhe punëtorëve shëndetësor, u mbajtën tre punëtori edukative në tema lidhur me shëndetin seksual dhe riprodhues, sëmundjet ngjitëse, si dhe të drejtat sociale dhe shëndetësore. Me përfshirjen aktive të bashkësisë rome u përgatit material edukative, Kalendar për vitin 2018, ku janë shfaqur gjashtë çështjet më të rëndësishme shëndetësore për bashkësinë rome, nëpërmjet cilës do të zgjidhen pjesë e tabu temave të përfaqësuara në mjediset rome.


Instituti për shëndet publik, në anën tjetër, zhvilloi një sërë trajnimesh dhe ligjëratah për zhvillim të kompetencave kulturologjike dhe strukturore të punëtorëve shëndetësor për punë me pacientët rom dhe përfaqësues të grupeve tjera të marginalizuara. U zhvillua shkolla verore për tridhjetë studentë dhe trajnime të akredituara (në kuadër të edukimit të vazhdueshëm të mjekëve) për specializant të



mjekësisë interne. Në shënimin e 25 vjetorit të FShHM u promovuan libri dhe praktikumi "Kompetencat kulturologjike dhe strukturore të punëtorëve shëndetësor", të paraparë për studentë të shkencave mjekësore, punëtorëve shëndetësorë dhe gjitha profilet tjera që marrin pjesë në sigurimin e shërbimeve shëndetësore. Në kuadër të programeve mësimore për studim për studentë të mjekësisë së përgjithshme si dhe studimet tjera mjekësore trevjeçare, dhe në studimet e magistraturës dhe doktoratës në shkencat e mjekësisë, lënda *Kompetencat kulturologjike dhe strukturore për punëtorë*

shëndetësor është akredituar si lëndë zgjedhore.

Në nëntor të vitit 2018, FShHM në partneritet me Fondacionin IDEA Evropa Juglindore dhe programi tematik për shëndet publik ndaj Fondacionit Shoqëri e Haur organizoi trajnime për organizatat qytetare që punojnë me bashkësitë e marginalizuara për zbatim të aktivizimit kreativ në punën me grupet e synuara. Në trajnimin morën pjesë 25 aktivist qytetar, përfaqësues të trembëdhjetë organizatave qytetare, që kishin mundësi të njihen me mënyrat e ndryshme të përdorimit dhe funksionimit



të artit, si vegël për dërgim të mesazheve, me qëllim që të nxitet ndryshimi i vetëdijes për dallimet në shoqëri dhe pranimin e tyre nga ana e individëve dhe grupeve në shoqëri.

Qëndrueshmëria e programeve parandaluese për HIV

Në vitin 2018, në kontekst të vazhdimin të tregimit të suksesshëm të Maqedonisë për tranzicionin nga mbështetja financiare nga Fondi Global kah financimi i qëndrueshëm i programeve parandaluese për HIV nga buxheti qendror i Republikës së Maqedonisë, FShHM vazhdo mbështetjen e procesit të përfaqësimit që drejtojnë Shoqata për Mbështetje të Personave që jetojnë me HIV Së Bashku më të Fuqishëm dhe HERA – Shoqata për Edukim Shëndetësor dhe Hulumtim. Në kuadër të takimit vjetor të Bordit Drejtues të Fondit Global u sigurua mbështetja logjistike për realizim të takimit në nivel të lartë të ministrave për shëndetësi të vendeve të Evropës Juglindore, ku u theksua nevoja për drejtim dhe llogaridhënie në rritjen e financave të buxheteve kombëtare për themelimin e programeve të qëndrueshme për luftë kundër HIV dhe tuberkulozë në këto vende. Nëpërmjet shpërndarjes së përvojave, leksioneve të marra dhe praktikave të mira, diskutimet në takim theksuan mirëmbajtjen e bashkëpunimit të mëtutjeshëm me qeveritë nga rajoni, organizatat qytetare, donatorët dhe partnerët multilateral.

Mbështetje për procesin e deinstitutionalizimit

Në vitin 2018 FShHM nënshkroi marrëveshje me Ministrinë e Punës dhe Politikës Sociale me Shoqatën e Defektologëve të Republikës së Maqedonisë për mbështetje të cilësisë së deinstitutionalizimit të Entit të Posaçëm Demir Kapija. Është siguruar mbështetje për përgatitje të programeve individuale për 67 personave të moshuar me pengesa intelektuale, me qëllim që të vazhdojnë jetën jashtë institucionit. Në proces u kyç edhe Shoqata për mbështetje të Personave me Nevoja të Posaçme SOLEM, që punoi në krijimin e shkathtësive për vet-përcaktim dhe vet-përfaqësim tek këto persona. Në fillim të vitit 2019 pritet të nxirret grupi i parë i personave të mbrojtur nga Enti i Posaçëm Demir Kapija dhe përfshirja e tyre në njësitë për jetesë të pavarur me mbështetje. Veç kësaj, në vitin 2018, nëpërmjet programit tematik për shëndet publik ndaj Fondacioneve Shoqëri e Hapur, FShHM siguroi mbështetje për Shoqatën për mbështetje të personave me nevoja të posaçme SOLEM për sigurim të qëndrueshmërisë së ndërmarrjes sociale “Artizane dore për ty” (HANDCRAFTS4U), që siguron përfshirje të vërtetë të personave me pengesa intelektuale në procesin e punës.

Në fund të vitit u dha grant i Shoqatës së qytetarëve Qendra e resurseve të prindërve të fëmijëve me nevoja të posaçme, me qëllim që të përforcohen lidhjet familjare, kapacitetet psiko-sociale dhe emocionale të anëtareve të familjeve, vëllezërve dhe motrave të fëmijëve me pengesa.

LISTA E GRANTISTËVE NË VITIN 2018

Pjesëmarrja qytetare për kohezion shoqëror		
GRANTISTË	SYNIMI/OBJEKTIVA	SHUMA E GRANTIT NË DENARË
Rumena Buzharovska	PicPrijç – natë e rrëfimit të historive të grave	86.393,66
Templum DOOEL, Shkup	Mbështetje të internet portalit “Okno” për vitin 2018	512.722,00
TRD Radio Kanal77, Shtip	Maqedonia nuk është vetëm Shkupi	312.760,42
TRD TV Koha DOOEL, Tetovë	Arsimi i personave me aftësi të kufizuar në Komunën e Tetovës	256.361,00
Qendra Rome Kulturore dhe Mediatike “Barikanipe”, Shkup	Njihni fqinjën tuaj rome	256.361,00
TRD Televizioni Plus, DOO, Kumanovë	Zhvillimi i përgjegjësisë shoqërore	307.633,20
TRD TV Studio “Tera” DOOEL, Manastir	Bota virtuale	302.505,98
Shoqata për Demokraci Lokale Qendra e Komunitetit të Komunës Strugë, Strugë	Përforcimi i rolit të qytetarëve për pjesëmarrje aktive në shoqërinë	393.770,50
Shoqata për Avancimin dhe Mbrojtjen e të Drejtave të Punëtorëve Punëtor i Denjë, Prilep	Projekt 189 – Përmirësimi i kushteve të punës së punëtorëve vendor në komuniteteve lokale në Prilep dhe Shtip	507.594,78
Shoqata e Qytetarëve me Sëmundje të Veshkave, NEFRON, Shkup	Fushatë për ngritjen e vetëdijes publike për dhurimin e organeve	440.787,10

Koalicioni Rural, Kumanovë	Perspektiva gjinore dhe organizatat lokale qytetare të përfshirë në politikat lokale për bujqësi dhe zhvillim rural	432.429,73
Këshilli Kombëtar Rinor i Maqedonisë, Shkup	Përse Ligji për të Rinj në RM?	508.620,22
Shoqata e Qytetarëve Teatër i Zgjuar, Shkup	Mbyll Sytë" Paramendo ndryshimin	287.124,32
Shoqata për Mundësi të Barabarta dhe Bashkëpunim Ndëretnik AL-MA, Shkup	Fëmijët nuk bëjnë dallim	237.903,01
Shoqata për Zhvillim Rural Grupi Lokal i Aksionit Agro Lider, Krivogashtani	Realizojmë Bashkërisht!	208.882,94
Qendra për Analiza Ekonomike - CEA, Shkup	Rritja e fuqisë së qytetarëve në ndikimin e tyre mbi politikat lokale në Komunën Sopsishte	266.615,44
Shoqata Iniciativa për Aktivizëm të Pavarur Kulturor INKA, Strugë	Platforma e përbashkët për kulturë "Kultura nga Gjithë për të Gjithë"	307.530,66
Shoqata për Disleksi Ajshtajn, Shkup	Informacione transparente për disleksinë	278.664,41
Shoqata për Mbrojtje dhe Edukim të Fëmijëve dhe të rinjve rom "Progres", Shkup	Të rinj të bashkuar për ndryshime pozitive	256.873,72
Multikultura, Tetovë	Me anë të arsimit profesional në punësim	252.259,22
Adelaid Karishiq	Boshnjakët e rinj dhe vetëqeverisja lokale	276.869,88
Aleksandra Milevska Taneska	Bashkë kujdesemi për mjedisin tonë	307.633,20
Hazize Jonuzi	Edhe unë kam të drejtë për jetë dinjitoze	307.633,20
Sijka Pishtollova	Energjia e gjelbër – zgjidhje për të ardhmen	235.852,12

Shoqata e Qytetarëve Romaveristas, Shkup	Bëhu pjesë e komunitetit – Debato!	256.104,64
SHQ Instituti për Sëmundje të Alchajmerit dhe Neurologjisë, Shkup	Ngritja e vetëdijes publike për sëmundjen e Alchajmerit dhe reintegrimi shoqëror i të sëmurëve dhe familjeve të tyre	230.212,18
Shoqata e Qytetarëve LEGIS, Shkup	Të rinjtë veprojnë për solidaritet	366.596,23
Shoqata e Juristëve Legal Tink, Shtip	#AktivizëmStudentor	251.233,78
Nela Vitosheviq	Bursë për pjesëmarrje në shkollën Directors Lab të Teatrit Lincoln Centre	221.752,27
Enti Qendra për Arte Bashkëkohore, Shkup	Aktivizëm kreativ/artistik	1.025.444,00
Angel Dimitrievski	Njohja dhe veprimi për dhunë të bashkëmoshatarëve dhe shqetësimi me anë të teatrit	256.155,91
Jugosllav Spasiq	Eko Grafit Fest për vetëdije më të lartë urbane	205.088,80
Shpendi Salija	Muzikoterapi, punëtori psiko-sociale për fëmijë me pengesa dhe prindërit e tyre	213.651,26
Gjorgje Jovanoviq	Njësia për intervenime të shpejta artistike	230.724,90
Tosho Filopovski	Tej timit 2!!!	205.088,80
Anderj Mitevski	Mblidh bërlllok, bëj art	207.652,41
Adem Sulejmanoski	Lend Art dhe aksione kreative mbi infrastrukturën e dëmtuar	210.216,02
Goce Stojanovski	Ejani të ruajmë autencitetin e arkitekturës së vjetër qytetare maqedonase	171.761,87

Tihomir Topuzovski	Hapësira të identifikimit politik, mobilizimit dhe ndarjeve (Rasti me Qytetin e Shkupit	220.470,46
Goran Kostovski	Selebrejt lajf – Emocione për një qytet	220.470,46
Iskra Dimitrova	Bibliografia e një vepre	227.494,75
Filip Jovanovski	Lirimi i Shkupit – ekspozitë dhe aksion në hapësirë publike	194.834,36
GJITHSEJ:		12.456.734,81

Shoqëria qytetare krijon politika publike		
GRANTISTË	SYNIMI/OBJEKTIVA	SHUMA E GRANTIT NË DENARË
EUROTINK – Qendra për Strategji Evropiane, Shkup	Viti i shansit – nëpërmjet veshëve me gjilpëra	3.076.332,00
Komiteti i Helsinkit për të Drejta të Njeriut i Republikës së Maqedonisë, Shkup	Për drejtësi – aksion i përbashkët për monitorimin e reformave gjyqësore dhe përfaqësimit për zbatimin e tyre	1.281.805,00
Transparenca Maqedoni, Shkup	Përfshirja e Platformës për Monitorim dhe Debatim në luftën kundër korrupsionit në RM	1.281.702,46
Koalicioni Të Drejta Seksuale dhe Shëndetësore të Komuniteteve të Margjinalizuar MARGINI, Shkup	ZSZD nën Ilupë: Monitorimi i zbatimit të ligjit të ri Ligjit për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Diskriminimi	1.244.889,02
Metamorfozis, Shkup	Vërtetëmatës.mk	1.025.444,00
GJITHSEJ:		7.910.172,48

Mbështetje të Maqedonisë për integrim në BE dhe NATO

GRANTISTË	SYNIMI/OBJEKTIVA	SHUMA E GRANTIT NË DENARË
Koalicioni i Shoqatave të Qytetarëve "Të gjithë për gjykim të drejtë", Shkup	Monitorimi i lëndëve gjyqësore nga fusha e krimit të organizuar dhe korrupsionit	152.278,43
GJITHSEJ:		152.278,43

Aleanca Qytetare për Transparencë – Monitorimi i procesit të reformave të administratës publike nga ana e organizatave qytetare

GRANTISTË	SYNIMI/OBJEKTIVA	SHUMA E GRANTIT NË DENARË
Shoqata e Analistëve dhe Hulamtuese të Rinj, ZMAI, Shkup	Aktivite për avancimin e kapaciteteve të infrastrukturës dhe teknike-teknologjike të shkollave fillore nga Çeshinovo-Obleshevo dhe Bogdanci.	552.002,01
Qendra e Qytetarëve Aktiv AKTIVO, Veles	Qytetarë të edukuar dhe të informuar parakusht për institucione transparente	485.776,53
Shoqata për Zhvillim Lokal AKSION PLUS, Resnjë	Institucione efikase lokale	442.979,00
Qendra për Zhvillim të Qëndrueshëm të Komunitetit, Dibër	Rritja e cilësisë së shërbimeve publike në nivel lokal me anë të zbatimit të e-shërbimeve në komunat Dibër, Mavrovë-Rostushë dhe Centar-Zhupa	538.658,53
Shoqata për Hulim të Tregut të Punës në Funkcion të Tolerancës Multietnike PROFICIO, Shkup	Pushtet lokal transparent dhe efikas—kushte për zhvillim	511.295,17

Shoqata për Promovim dhe Zhvillim të Shoqërisë Inkluzive INKLUZIVA, Kumanovë	Të qasshme dhe në dispozicion – informacione dhe shërbime publike	542.655,43
GJITHSEJ:		3.073.366,67

INTEGRIMI NDËRETNIK NË ARSIM

GRANTISTË	SYNIMI/OBJEKTIVA	SHUMA E GRANTIT NË DENARË
SHFK "J.H. Pestalloci", Shkup	Çmim në materiale didaktike dhe tjera dhe pajisje për shkollën në të cilën punon mësimitdhënësi me çmim të parë në thirrjen "Mësimitdhënësi të Suksesshëm për Praktika të Mira Mësimore"	50.000,00
SHF "Glogor Përliçev", Ohër	Çmim në materiale didaktike dhe tjera dhe pajisje për shkollën në të cilën punon mësimitdhënësi me çmim të dytë në thirrjen "Mësimitdhënësi të Suksesshëm për Praktika të Mira Mësimore"	40.000,00
SHFK "Rajko Zhinsifov", Orizare e Epërme, Veles	Çmim në materiale didaktike dhe tjera dhe pajisje për shkollën në të cilën punon mësimitdhënësi me çmim të tretë në thirrjen "Mësimitdhënësi të Suksesshëm për Praktika të Mira Mësimore"	30.000,00
SHFK "Kuzman Josifovski Pitu", Kërçovë	Çmim në materiale didaktike dhe tjera dhe pajisje për shkollën në të cilën punon mësimitdhënësi lëndor me çmim të parë në thirrjen "Mësimitdhënësi të Suksesshëm për Praktika të Mira Mësimore"	50.000,00
SHFK "Jan Amos Komenski", Shkup	Çmim në materiale didaktike dhe tjera dhe pajisje për shkollën në të cilën punon mësimitdhënësi lëndor me çmim të dytë në thirrjen "Mësimitdhënësi të Suksesshëm për Praktika të Mira Mësimore"	40.000,00

SHFK "7 Marsi", Likovë	Çmim në materiale didaktike dhe tjera dhe pajisje për shkollën në të cilën punon mësimitdhënësi lëndor me çmim të tretë në thirrjen "Mësimitdhënësi të Suksesshëm për Praktika të Mira Mësimore"	30.000,00
SHMK Gjimnazi "Jsip Broz Tito", Manastir	Çmim në materiale didaktike dhe tjera dhe pajisje për shkollën në të cilën punon profesori me çmim të parë në thirrjen "Mësimitdhënësi të Suksesshëm për Praktika të Mira Mësimore"	50.000,00
SHMK "Nikolla Karev", Strumicë	Çmim në materiale didaktike dhe tjera dhe pajisje për shkollën në të cilën punon profesori me çmim të tretë në thirrjen "Mësimitdhënësi të Suksesshëm për Praktika të Mira Mësimore"	30.000,00
SUGS "Orce Nikollov", Shkup	Çmim në materiale didaktike dhe tjera dhe pajisje për shkollën në të cilën punon profesori me çmim të dytë në thirrjen "Mësimitdhënësi të Suksesshëm për Praktika të Mira Mësimore"	40.000,00
Shoqata për Mbështetje të Fëmijëve dhe të Rinjve me Dallime Zogu Blu, Shkup	Në përfshirje me bashkëpunim	256.361,00
Shoqata për Edukim dhe Zhvillim të Personave me Pengesa në Zhvillim Barazi, Strumicë	Përfshirja nuk është iluzion	254.822,83
Dendo Vas, Qendra për Mbështetje Arsimore, Shkup	Arsim për të gjithë	256.361,00
Qendra për Mbështetje të Personave me Pengesa Intelektuale PORAKA Veles, Veles	Shoqërohemi, njoftohemi, mësojmë, përparojmë	256.053,37
SHF Vëllezërit Ramz dhe Hamid, Shkup	Oda e lumturisë	205.088,80
POU Dituria, Shkup	Saraji i ynë i gjelbër, është diçka!	205.088,80

SHFK Rajko Zhinsifov, Orizare e Epërme, Veles	Rritemi bashkë	199.038,68
SHFK Svetozar Markoviq, f. Staro Nagoriçane	Jo njëri afër tjetrit – njëri me tjetrin	200.628,12
SHFM Vanço Përke, Dellçevë	Mësim dhe njohje me shoqërim të përbashkët në kushte bashkëkohore	138.434,94
SHFK Zdravkovski Penko, Shkup	Dhuna e bashkëmoshatarëve - bulling	204.576,08
SHFK Vasill Glavinov, Veles	Kohezioni social – çelësi i suksesit	204.986,26
SHFK Murat Llabunishti, f. Llabunishtë	Bashkë mundemi më shumë	205.088,80
SHFK Strasho Pinxhur, f. Josifovo	Krijojmë një shkollë në të cilën të lidhur arrijmë qëllimet më të larta	164.840,12
SHFK Mite Bogoevski, Resnjë	Fëmijë të lumtur, prindër të kënaqur, shkollë funksionale	203.704,45
Fondacioni për Iniciativa Arsimore dhe Kulturore “Haps pas hapi”, Shkup	Mbështetja administrative dhe programore	1.281.805,00
Fondacioni për Iniciativa Arsimore dhe Kulturore “Haps pas hapi”, Shkup	Komunitete për mësim	1.025.444,00
Shoqata e Qytetarëve “Forumi Rinor Arsimor”, Shkup	Shtëpi studentore pa korrupsion	2.589.246,10
GJITHSEJ:		8.211.568,35

Qytetarët për ardhmërinë		
GRANTISTË	SYNIMI/OBJEKTIVA	SHUMA E GRANTIT NË DENARË
Enti Qendra për Arte Bashkëkohore, Shkup	Aksione urbane për EC PËRPARA	430.686,48
Koalicioni Rural, Kumanovë	Bujqësia maqedonase në rrugën drejt politikës së përbashkët bujqësore të Be-së - sfida dhe mundësi	264.051,83
OJQ Inforqendër, Shkup	EUreka	650.644,22
HERA – Asociacioni për Edukim dhe Hulumentim Shëndetësor, Shkup	Qytetarët për ardhmërinë	161.507,43
Komiteti i Helsinkit për të Drejta të Njeriut i Republikës së Maqedonisë, Shkup	Përfitimet nga aderimi në Bashkimin Evropian	501.288,30
Shoqata për Emancipim, Solidaritet dhe Barazi të Grave – ESE, Shkup	Përfitimet e RM-së nga anëtarësia në BE në kuptim me shëndetin, mbrojtjes shëndetësore të qytetarëve dhe për përfshirje të romëve	179.452,70
Civil – Qendra për Liri, Shkup	Po, për ardhmëri evropiane	512.722,00
Shoqata e Qytetarëve "Forumi Rinor Arsimor", Shkup	Fushata rinore Mendo me Zë	501.954,84
GJITHSEJ:		3.202.307,80

Strategjia rrjet për përforsimin ligjor		
GRANTISTË	SYNIMI/OBJEKTIVA	SHUMA E GRANTIT NË DENARË
OJQ KHAM, Dellçevë	Llogaridhënia sociale dhe përforsimi ligjor i komunitetit rom	5.524.066,83

IRIZ – Iniciativa për Zhvillim dhe Përfshirje të Komuniteteve, Shkup	Llogaridhënia sociale dhe përforcimi ligjor i komunitetit rom	3.691.598,40
Qendra Kombëtare Rome, Kumanovë	Avancimi i mbrojtjes shëndetësore të romëve	2.819.971,00
Romano Çaçipe, Shkup	Llogaridhënia sociale dhe përforcimi ligjor i komunitetit rom	1.583.131,72
OJQ KHAM, Dellçevë	Zbatimi i mënyra inventive për financim të aktiviteteve për përforcim ligjor	256.361,00
Shoqata për Emancipim, Solidaritet dhe Barazi të Grave – ESE, Shkup	Zbatimi i mënyra inventive për financim të aktiviteteve për përforcim ligjor	99.621,88
Komiteti i Helsinkit për të Drejta të Njeriut i Republikës së Maqedonisë, Shkup	Zbatimi i mënyra inventive për financim të aktiviteteve për përforcim ligjor	153.816,60
Shoqata Irbor, Strumicë	Zbatimi i mënyra inventive për financim të aktiviteteve për përforcim ligjor	76.908,30
HOPS – Opsione për Jetë të Shëndoshë Shkup	Zbatimi i mënyra inventive për financim të aktiviteteve për përforcim ligjor	97.929,90
IRIZ – Iniciativa për Zhvillim dhe Përfshirje të Komuniteteve, Shkup	Zbatimi i mënyra inventive për financim të aktiviteteve për përforcim ligjor	127.872,87
Shoqata Maqedonase e Juristëve të Rinj, Shkup	Zbatimi i mënyra inventive për financim të aktiviteteve për përforcim ligjor	122.540,56
HERA – Asociacioni për Edukim dhe Hulimtim Shëndetësor, Shkup	Zbatimi i mënyra inventive për financim të aktiviteteve për përforcim ligjor	153.816,60
Fakulteti Juridik "Justiniani i Parë", Shkup	Klinika ligjore për grupe të cenuar	1.006.473,29
Shoqata Maqedonase e Juristëve të Rinj, Shkup	Avancimi i ndihmë ligjore falas dhe mënyrat alternative për zgjidhjen e kontesteve në RM	1.132.295,26
Asociacioni për Zhvillim Demokratik të Romëve "SONCE", Tetovë	Avancimi i politikave lokale për sigurim të qasjes në drejtësi	2.077.754,63
Shoqata për Emancipim, Solidaritet dhe	Standardizimi dhe qëndrueshmëria e sigurimit të llojeve të	2.002.948,49

Barazi të Grave – ESE, Shkup	ndryshme të ndihmë ligjore falas	
Qendra Kombëtare Rome, Kumanovë	Qasje në drejtësi në Maqedoni	637.723,62
Qendra Kulturore Rinore, Manastir	Qasje në drejtësi në Maqedoni	516.311,05
Komiteti i Helsinkit për të Drejta të Njeriut i Republikës së Maqedonisë, Shkup	Qasje në drejtësi në Maqedoni	700.019,35
Shoqata Izbor, Strumicë	Qasje në drejtësi në Maqedoni	369.159,84
EHO- Organizatë Humanitare Edukative, Shtip	Qasje në drejtësi në Maqedoni	371.467,09
Komiteti i Helsinkit për të Drejta të Njeriut i Republikës së Maqedonisë, Shkup	Përforcimi ligjor i punëtorëve të tekstilit për vetëpërfaqësim	2.050.888,00
Koalicioni Të Drejta Seksuale dhe Shëndetësore të Komuniteteve të Margjinalizuar MARGINI, Shkup	Shkrirja e Qëllimit 16.3 nga qëllimet globale të OKB-së për zhvillim të qëndrueshëm në nivel kombëtar	1.347.946,14
GJITHSEJ:		26.920.622,42

Angazhimi i të rinjve		
GRANTISTË	SYNIMI/OBJEKTIVA	SHUMA E GRANTIT NË DENARË
Shoqata e Qytetarëve “Forumi Rinor Arsimor”, Shkup	Angazhimi i të rinjve	5.127.220,00
Asociacioni për të Rinj IMKA, Manastir	Programi për zhvillimin e të rinjve GLOU dhe UMAP	475.447,11
OJQ Zhvillimi Qytetar – GR, Likovë, Kumanovë	Të heqim maskat. Fytyrat i kemi të bukura	512.209,28
Shoqata për Vullnetarizëm, Qendra	Pa grindje	502.467,56

Vullnetare, Kisella Voda		
Paktis Shoqata Qendra për Strategji dhe Zhvillim, Prilep	Aktivizohu kundër urrejtjes dhe lajmeve të rreme	507.082,06
Shoqata për Disleksi Ajnshtajn, Shkup	E drejta e të folurit NUK është e drejta e të folurit të urrejtjes	512.670,73
Lidhja e Skautëve të Maqedonisë, Shkup	krijimi i urave kulturore mes të rinjve nga Maqedonia Lindore dhe Perëndimore	510.671,11
Ekipi i parë i skautëve të Shkupit, Shkup	Dialog ndërkulturor në lëvizje	405.050,38
GJITHSEJ:		8.552.818,23

Politika shëndetësore të bazuar në të drejta

GRANTISTË	SYNIMI/OBJEKTIVA	SHUMA E GRANTIT NË DENARË
Fondacioni IDEA Evropa Juglindore, Shkup	Ndryshimi i narrativëve për romët në institucionet shëndetësore	1.507.402,68
HERA – Asociacioni për Edukim dhe Hulumtim Shëndetësor, Shkup	Ndryshimi i narrativëve për romët në institucionet shëndetësore	1.538.166,00
Asociacioni për Zhvillim Demokratik të Romëve "SONCE", Tetovë	Ndryshimi i narrativëve për romët në institucionet shëndetësore	1.522.784,34
Shoqata e Punëtorëve në Arsim për Mbrojtjen e të Drejtave të Grave dhe Fëmijëve – LIL, Shkup	Ndryshimi i narrativëve për romët në institucionet shëndetësore	1.281.805,00
OJQ KHAM, Dellçevë	Ndryshimi i narrativëve për romët në institucionet shëndetësore	1.504.839,07
Qendra Kombëtare Rome, Kumanovë	Ndryshimi i narrativëve për romët në institucionet shëndetësore	1.248.478,07
Qendra e Resursit të Prindërve me Fëmijë me Aftësi të Kufizuar, Shkup	Mbështetja psikologjike e familjeve me fëmijë me aftësi të kufizuar	461.449,80

Koalicioni Të Drejta Seksuale dhe Shëndetësore të Komuniteteve të Margjinalizuar MARGINI, Shkup	Avancimi i të drejtave seksuale dhe shëndetësore të komuniteteve të marginalizuar	4.984.580,74
Shoqata për Emancipim, Solidaritet dhe Barazi të Grave – ESE, Shkup	Mbështetja institucionale për ESE	17.176.187,00
HOPS – Opsione për Jetë të Shëndoshë Shkup	Mbështetja institucionale për HOPS	7.562.649,50
HOPS – Opsione për Jetë të Shëndoshë Shkup	Monitorimi i zbatimit të programeve parandaluese për avancim të shëndetit të personave që përdorin droga	5.639.942,00
Shoqata për Mbështetjen e Personave me Aftësi të Kufizuar SOLEM, Shkup,	Artizane dore për ju	3.076.332,00
Shoqata për Mbështetjen e Punëtorëve të Margjinalizuar STAR-STAR, Shkup	Përforcimi i kapaciteteve organizuese të STAR-STAR	1.794.527,00
GJITHSEJ:		49.299.143,20

GJITHSEJ GRANTE PËR VITIN 2018 119.779.012,39 DENARË

**Fondacioni Shoqëri e Hapur –
Maqedoni**

Bul. Jane Sandanski 111,
Kutia Postare 387, 1000 Shkup;
Telefon për kontakt:
+389 2 2444 488
e-adresa: fosm@fosm.mk



FOUNDATION ФОНДАЦИЈА
OPEN ОТВОРЕНО
SOCIETY ОПШТЕСТВО
MACEDONIA МАКЕДОНИЈА